# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5850
E shtunë, 10 gusht 2019
çmimi 0.40 €


## Carpenter: Zgjedhjet në Kosovë dhe Serbi mund ta vonojnë arritjen e marrëveshjes

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de





FLET PËR "EPOKËN E RE", RESHAT EF. MEXHIDI FAQE 4-5

# BIK-u ka mision edukimin e drejtë të të rinjve



Zëvendëskryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Reshat ef. Mexhidi, ka bërë me dije se Bashkësia Islame e Kosovës ka për mision edukimin e drejtë të të rinjve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" në prag të festës së Kurban Bajramit, Mexhidi ka thënë se për BIK-un është shqetësuese rritja e numrit të përdoruesve të lëndëve narkotike nga të rinjtë tanë dhe rritja e aksidenteve me vdekshmëri. Ai ka deklaruar se do të vazhdojnë të angazhohen për ruajtjen e rinisë në mënyrë që të kemi një shoqëri të shëndoshë, të arsimuar e të kulturuar, që njeh Zotin. Mexhidi në këtë intervistë ka folur edhe për rëndësinë e shumëfishtë të prerjes së kurbanit, duke shtuar se për besimtarët myslimanë - për ata që kanë mundësi - prerja e kurbanit është obligim

## AKTUALE

**NJË E KATËRTA E POPULLSISË NË BOTË RREZIKOHET NGA MUNGESA E UJIT** F. 2

**GJENDEN 15 KILOGRAMË MARIJUANË NË AFËRSI TË RRUGËS GJILAN - BUJANOC** F. 7

**MINISTRI GASHI: RINIA, PASURIA MË E MADHE E KOSOVËS** F. 6

**RRITJE REKORDE E STENTIMEVE DHE KORONAROGRAFIVE NË QKUK** F. 5

# Certifikohet gjenerata e parë e FSK-së me mandatin e ri ushtarak



Radhëve të ushtrisë së Republikës së Kosovës të premten u janë shtuar edhe 337 rekrutë të rinj. Ata kanë bërë betimin për t'i shërbyer atdheut në një ceremoni solemne pasi kanë përfunduar me sukses trajnimin bazik nëntëjavësh. Kjo është gjenerata e parë e rekrutëve që i bashkohen Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) me mandatin e ri ushtarak FAQE 3

## EKONOMI

**VONESAT NË TC 'KOSOVA E RE' MUND TË SJELLIN PENALIZIME** F. 9

**ÇEKIA SË SHPEJTI NIS INVESTIMET NË KOSOVË NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE** F. 8

# A ka para për zgjedhje të parakohshme?

FAQE 6



## KULTURË

**FUQIA E POPULLIT TË ROBËRUAR QË IA THEU KURRIZIN ROBËRISË SERBE NË KOSOVË NË BALLË ME UÇK-në** F. 16

Prof. dr. Hakif BAJRAMI




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Rama: Maqedonia e Veriut para Shqipërisë në BE, mund ta destabilizojë rajonin

Tiranë, 9 gusht - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një intervistë për medien "Euronews" nga rezidenca e tij në Dhërmi, ka paralajmëruar vendet e Bashkimit Evropian se do të jetë e dëmshme për rajonin nëse nisin bisedimet e pranimit për Maqedoninë e Veriut para Shqipërisë. "Do të ishte shumë e dëmshme për rajonin dhe në të njëjtën kohë do të ishte e padrejtë. Po Maqedonia bëri përparim dhe meriton të vlerësohet sepse e meriton, por pyetja është: A na duhet konflikt për t'u vlerësuar për atë që bën", ka thënë Rama.



# Carpenter: Zgjedhjet në Kosovë dhe Serbi mund ta vonojnë arritjen e marrëveshjes

Prishtinë, 9 gusht - Ish-zyrtari i Pentagonit që ka qenë përgjegjës për Ballkanin, Michael Carpenter, ka vlerësuar se zgjedhjet e ardhshme në Kosovë, si dhe zgjedhjet e vitit 2020 në Serbi, mund ta vonojnë marrëveshjen midis Beogradit dhe Prishtinës. Carpenter ka theksuar në një intervistë për "Zërin e Amerikës" në gjuhën serbe, se periudha e zgjedhjeve është një kohë shumë e keqe për të negociuar marrëveshje ndërkombëtare. "Fakti që Kosova nuk ka një kryeministër është një pengesë e madhe dhe koha e zgjedhjeve është gjithashtu e përshtatshme për ata që mbrojnë pikëpamje më të ashpra politike, gjë që është e keqe për të arritur një marrëveshje. Unë nuk do të thosha që një marrëveshje është e pamundur, por duket se nuk ka gjasa", ka deklaruar Carpenter. Sipas tij, rrethanat politike të brendshme në Serbi dhe Kosovë duket se janë të tilla, që ideja e një "shkëmbimi territoresh" mund të ketë sukses por, sipas tij, ende ka ardhur momenti për këtë, as në Kosovë dhe as në Serbi. "Unë nuk besoj se vazhdimi i dialogut, i udhëhequr nga Federica Mogherini, do të çonte në diçka konkrete. Unë mendoj se nëse Serbia dëshiron të kapërcejë atë pengesë, dhe ta njohë pavarësinë e Kosovës, do të duhet të marrë diçka shumë konkrete në këmbim, diçka që qytetarët do ta konsiderojnë të vlefshme", ka thënë ai.

Carpenter ka shtuar se administrata aktuale e ShBA-së dëshiron ta shfrytëzojë mundësinë për ta zgjidhur mosmarrëveshjen midis Serbisë dhe Kosovës, duke shtuar se mbështetja për idenë e shkëmbimit të territorit nuk ka asnjë lidhje me ndarjet partiake në Amerikë. Duke iu referuar rolit eventual të Rusisë, Carpenter ka pohuar se "nga këndvështrimi i Moskës është më mirë të vazhdojë një konflikt midis Kosovës dhe Serbisë, sepse kjo i lejon Rusisë të paraqitet si mbrojtëse e interesave serbe dhe kundërshtare e Kosovës". "Unë nuk mendoj se është në interesin e Kremlinit për ta zgjidhur këtë çështje", ka thënë zyrtari amerikan.



# Një e katërta e popullsisë në botë rrezikohet nga mungesa e ujit

Prishtinë, 9 gusht - Shtatëmbëdhjetë vende, në të cilat jeton një e katërta e popullsisë së botës, janë në rrezik ekstrem për mungesë të ujit, thuhet në një raport të Institutit të Burimeve Botërore (WRI).

Katari, Izraeli, Libani, Irani dhe Jordania janë në krye të listës së 164 vendeve më të rrezikuara nga mungesat e mundshme të ujit për të cilat, sipas raportit të WRI, edhe thatësira më e vogël mund të jetë një kërcënim i madh, pasi ato po shpenzojnë pothuajse të gjitha rezervat e mundshme të ujit.



Në grupin e 17 vendeve që janë të ekspozuara ndaj "rrezikut jashtëzakonisht të lartë të ujit", sipas studimit, shumica janë nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut. Këto vende përfshijnë: Libinë, Kuvajtin, Arabinë Saudite, Eritrean, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahrejnin, Indinë, Pakistanin, Turkmenistanin, si dhe San Marinon, si i vetmi vend evropian.

Nga ish-republikat jugosllave, Kroacia është më e sigurta, duke u renditur në vendin e 140, pasuar nga Mali i Zi (121), Sllovenia (117) dhe Serbia (109), të cilat klasifikohen si grupi më i madh i 64 vendeve me një rrezik të ulët të mungesës së ujit.

Bosnja dhe Hercegovina renditet në vendin e 97-të në listën WRI në grupin e vendeve me rrezik të "mesëm të ulët", ndërsa Maqedonia e Veriut renditet e 52-ta. "Rreziku nga mungesa e ujit është kriza më e madhe për të cilën askush nuk flet. Pasojat e tij janë qartë në formën e pasigurisë ushqimore, konfliktit, migracionit dhe paqëndrueshmërisë financiare", ka thënë Andrew Steer, president i WRI-së.

Studiuesit parashikojnë që gjendja nga mungesa e ujit do të përkeqësohet ndjeshëm për shkak të rritjes së popullsisë dhe ndryshimit të klimës.

## Meta kthen në Kuvend edhe kontratën për Portin e Jahteve - Orikum

Tiranë, 9 gusht - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, nuk e ka dekretuar të premten një tjetër ligj të hartuar nga qeveria dhe të votuar nga mazhoranca në Kuvend. Në vendimin që është bërë publik, presidenti i kërkon Kuvendit rishqyrtimin e PPP-së për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës "Porti i jahteve - By-Pass Orikum - Dukat (ura e Shën Elizës)".

Një ditë më parë presidenti Meta ka refuzuar ta dekretojë kontratën për ndërtimin e aksit rrugor Milot - Balldren. Në rishqyrtimin e koncesionit "Porti i jahteve - By-Pass Orikum - Dukat (ura e Shën Elizës)", institucioni i presidencës ka theksuar se "Ligji dhe kontrata koncesionare e bashkëlidhur janë propozuar, hartuar, nënshkruar dhe miratuar në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Rekrutët e rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë përfunduar me sukses trajnimin bazik nëntëjavësh

# Certifikohet gjenerata e parë e FSK-së me mandatin e ri ushtarak

Radhëve të ushtrisë së Republikës së Kosovës të premten u janë shtuar edhe 337 rekrutë të rinj. Ata kanë bërë betimin për t'i shërbyer atdheut në një ceremoni solemne pasi kanë përfunduar me sukses trajnimin bazik nëntëjavësh. Kjo është gjenerata e parë e rekrutëve që i bashkohen Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) me mandatin e ri ushtarak



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ushtrisë së Kosovës të premten i janë bashkuar 337 rekrutë të rinj të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimin bazik nëntëjavësh. Ata kanë bërë betimin për t'i shërbyer atdheut në një ceremoni të organizuar në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Kjo është gjenerata e parë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) me mandatin e ri ushtarak.

Me këtë rast komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka kërkuar nga ushtarët e rinj që të kontribuojnë në ngritjen dhe zhvillimin e ushtrisë së Kosovës. "Jam i lumtur që ju jeni ata që keni dëshmuar që FSK-ja do të ketë në radhët e veta djemtë dhe vajzat më të zotë të vendit. Nga ju pritet të jeni të disiplinuar e të përkushtuar. FSK-ja është forcë kredibile, shumetnike dhe e gatshme të kontribuojë në paqe. Ka filluar tranzicioni sipas planit të bazuar me mandatin e ri për mbrojtjen e sovranitetit të vendit. Kërkoj nga të gjithë pjesëtarët që të punojnë për ngritjen dhe zhvillimin profesional në mënyrë që tranzicioni të kryhet me sukses", ka deklaruar Rama.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, duke folur për rëndësinë e betimit të ushtarit për shërbim ndaj vendit, ka thënë se 9 gushti është një datë me rëndësi për FSK-në, Ministrinë e Mbrojtjes dhe për shtetin e Kosovës. "Nuk ka detyrë më të ndershme sesa t'i shërbesh vendit dhe të kontribuosh në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend dhe më gjerë. Ju jeni gjenerata e parë e ushtarëve që keni nderin t'i bashkoheni FSK-së me mandat të ri ushtarak. Si ministër i Mbrojtjes jam krenar me vajzat dhe djemtë tanë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, të cilët me sukseset e tyre në shkollat dhe trajnimet e përfunduara në akademitë e ndryshme të vendeve të NATO-s, kanë treguar performancë të shkëlqyer dhe kanë përfaqësuar me nder FSK-në. Pres që edhe ju ta ndiqni shembullin e tyre", është shprehur Berisha.

I pranishëm në këtë ceremoni ka qenë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Ai ka thënë se shteti ynë nuk e kërcënon askënd, por as nuk do të lejojë askënd ta cenojë atë. Sipas Veselit, integriteti territorial dhe kufijtë e shtetit tonë janë të shenjtë, të paprekshëm, sot dhe përgjithmonë. Ai e ka quajtur 9 gushtin ditë krenarie për të gjithë, ndërsa të qenit pjesëtar të ushtrisë më të re në botë, Veseli e ka cilësuar privilegj për të cilin do të kenë lakmi gjeneratat që do të vijnë pas. "Ju jeni pjesë e një force mbrojtëse të lindur e zhvilluar në partneritet me NATO-n, Aleancën më të fuqishme në botë, garantuese e vlerave të lirisë dhe demokracisë. Ne sot ndihemi krenarë me ju. Ne besojmë në përkushtimin atdhetar dhe profesionalizmin tuaj. Ju e keni nderuar atdheun kudo që keni marrë pjesë në garat ndërkombëtare, njësoj si sportistët tanë. Ju au keni dëshmuar aleatëve tanë seriozitetin dhe gatishmërinë tonë për të qenë pjesë e misioneve të përbashkëta në të mirë të paqes e njerëzimit. Me ju Kosova ndihet më e sigurt në të tashmen dhe të ardhmen e saj", ka deklaruar Veseli.

Ai ka thënë se Kosova po ndërton një ushtri e cila pasqyron shpirtin liridashës të popullit tonë, vlerat mbi të cilat qëndron shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës dhe vizionin tonë për të marrë vendin që na takon në strukturat politike dhe ushtarake perëndimore. "Ushtria e Kosovës është sot element i domosdoshëm i stabilitetit dhe paqes në rajon. Ushtria e Kosovës do ta vazhdojë procesin e fuqizimit e profesionalizimit të saj, për t'u bërë gati për fazën e anëtarësimit në NATO", ka theksuar Veseli, duke paralajmëruar rritjen e buxhetit për ushtrinë. Ai ka hënë se ka një ëndërr për ta bërë Kosovën vend të zhvilluar e të begatshëm për të gjithë qytetarët e saj. "Ne do t'ia dalim siç ia kemi dalë gjithmonë. Kosova ka veç një rrugë: rrugën përpara, zhvillim ekonomik, fuqizim të shtetit, integrim në NATO dhe BE. S'ka rrugë tjetër dhe s'do ta lejojmë askënd të na orientojë tjetërkah", është shprehur Veseli.

Nga 337 rekrutë, prej tyre 52 janë vajza si dhe 22 janë pjesëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë. Me lëvdatë për sukseset e larta të arritura gjatë stërvitjes janë shpërblyer rekrutët Shpëtim Halilaj, Luan Gashi, Diar Statovci, Donika Rexhepi, Blerta Veliu, Edmond Thaçi, Altin Krasniqi dhe Ermeka Muja. Kurse për shkathtësi të lartë fizike janë shpërblyer Gentrit Gashi dhe Doruntinë Cana.

## Presidenti Thaçi dekreton strukturën e re komanduese të FSK-së

Bazuar në pakon e re ligjore për FSK-në, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Sigurisë së Kosovës, presidenti Hashim Thaçi të premten ka dekretuar strukturën e re komanduese të FSK-së. Ai ka thënë se FSK-ja do të jetë gjithmonë e gatshme për t'i shërbyer kultivimit dhe forcimit të paqes në vend, rajon dhe botë. "Pas shndërrimit të FSK-së në një forcë ushtarake shumetnike, profesionale dhe të armatosur, me këtë dekret është kompletuar dhe funaksionalizuar kjo strukturë. FSK-ja do të jetë gjithmonë e gatshme për t'i shërbyer kultivimit dhe forcimit të paqes në vend, rajon dhe botë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Reshat ef. Mexhidi

# BIK-u ka mision edukimin




Zëvendëskryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Reshat ef. Mexhidi, ka bërë me dije se Bashkësia Islame e Kosovës ka për mision edukimin e drejtë të të rinjve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" në prag të festës së Kurban Bajramit, Mexhidi ka thënë se për BIK-un është shqetësuese rritja e numrit të përdoruesve të lëndëve narkotike nga të rinjtë tanë dhe rritja e aksidenteve me vdekshmëri. Ai ka deklaruar se do të vazhdojnë të angazhohen për ruajtjen e rinisë në mënyrë që të kemi një shoqëri të shëndoshë, të arsimuar e të kulturuar, që njeh Zotin. Mexhidi në këtë intervistë ka folur edhe për rëndësinë e shumëfishtë të prerjes së kurbanit, duke shtuar se për besimtarët myslimanë - për ata që kanë mundësi - prerja e kurbanit është obligim

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 GUSHT - Zëvendësmyftiu i Kosovës, Reshat ef. Mexhidi, ka deklaruar se është mision i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) që të angazhohet ta ruajë, ta udhëzojë dhe ta edukojë popullatën. Në vigjilje të festës së Kurban Bajramit, ai ka vlerësuar se është detyrë e të gjitha komuniteteve fetare në Kosovë të kujdesen sidomos për brezin e ri që të mos merret me dukuri negative. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mexhidi ka bërë me dije se BIK-u do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht në këtë mision. "Ne do të vazhdojmë të angazhohemi për edukimin e drejtë të të rinjve tanë. E kemi detyrë që të ruajmë e edukojmë drejt rininë dhe të ndërtojmë një shoqëri të shëndoshë, të arsimuar e të kulturuar, që njeh Zotin, respekton vlerat dhe ka ndjesinë humane e njerëzore", ka thënë Mexhidi.

Ai ka vlerësuar si tepër shqetësuese rritjen e disa fenomeneve negative te rinia jonë. "Për ne është shqetësuese rritja e numrit të përdoruesve të lëndëve narkotike nga të rinjtë tanë, po ashtu është shqetësuese edhe rritja e aksidenteve me fatalitet në rrugët tona. Ne si Bashkësi Islame në vazhdimësi predikojmë largimin nga dukuritë negative, këtë e bëjmë nëpër institucionet tona siç janë xhamitë, pastaj shfrytëzojmë edhe praninë tonë kudo në radhët e xhematit që të flasim për këto dukuri", është shprehur ai.

Në këtë intervistë Mexhidi ka folur edhe për rëndësinë e prerjes së Kurban Bajramit, duke shtuar se për besimtarët myslimanë - për ata që kanë mundësi - prerja e kurbanit është obligim. "Rëndësia e kurbanit është e shumëfishtë, sidomos për aspektin social, sepse prej qëllimeve të kurbanit është që përmes tij të kujdesemi më shumë për nevojtarët, jetimët e skamnorët. Mirëpo, duhet ditur se kurbani theret për Zotin e madhëruar në kohë të caktuar dhe me kritere të caktuara", ka deklaruar ai.

Zëvendësmyftiu i Kosovës ka treguar se besimtarët mund edhe ta paguajnë në institucionet e BIK-ut prerjen e kurbanit. "Ftoj besimtarët tanë që kurbanin ta paguajnë në institucionet e BI-së që t'i ndihmojnë institucionet arsimore të BI-së, t'i ndihmojnë ata që kanë nevojë dhe të jenë të sigurt që kurbani i tyre do të theret në kushtet e kërkuara si të sheriatit ashtu edhe kushtet sanitare", ka thënë Mexhidi.

**"Epoka e re":** *Si është gjendja e besimtarëve të Kosovës që kanë shkuar në Mekë për ta kryer haxhin, dhe a kanë filluar kryerjen e ibadeteve?*

**Mexhidi:** Fillimisht më lejoni të them se besimtarët tanë që këtë vit kanë bërë nijet ta kryejnë haxhin tashmë veç janë në Mekën e bekuar, ku edhe janë akomoduar dhe kanë filluar kryerjen e ibadeteve që kërkohen për umre dhe haxh. Sivjet në organizim të Bashkësisë Islame të Kosovës për ta kryer haxhin kanë udhëtuar 1 080 besimtarë, të cilëve u prinë vetë myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava. Së bashku me besimtarët tanë është edhe grupi i udhëheqësve që u prinë besimtarëve për ta kryer haxhin, si dhe ekipi mjekësor që kujdeset për gjendjen shëndetësore të besimtarëve tanë. Ne jemi në kontakt të përditshëm me përgjegjësit e haxhit dhe mund t'ju informoj se besimtarët tanë janë të akomoduar në kushte të mira, duke përfshirë këtu edhe ushqimin dhe transportin brenda Mekës. Deri më tani nuk ka ndonjë besimtar që ka shfaqur probleme shëndetësore.

**"Epoka e re":** *Jemi në prag të*

# e drejtë të të rinjve



*festës së Kurban Bajramit, ku besimtarët urdhërohen për therjen e një kafshe për hir të Zotit. Për një besimtar, cila është rëndësia e prerjes së kurbanit?*
Mexhidi: Vetë festa në vigjilje të së cilës jemi vjen pas kryerës së haxhit dhe therjes së kurbanit. Therja e kurbanit për besimtarët myslimanë është obligim për ata që kanë mundësi. Ndërsa rëndësia e kurbanit është e shumëfishtë, sidomos për aspektin social, sepse prej qëllimeve të kubanit është që përmes tij të kujdesemi më shumë për nevojtarët, jetimët e skamnorët. Mirëpo, duhet ditur që kurbani theret për Zotin e madhëruar në kohë të caktuar dhe me kritere të caktuara.

"Epoka e re": *Këtë vit a organizon Bashkësia Islame e Kosovës therjen e kurbaneve dhe si mund ta kryejë këtë obligim një besimtar?*
**Mexhidi:** Po, Bashkësia Islame e Kosovës ka bërë organizimin e tubimit për therjen kolektive të kurbanit. Siç dihet, tashmë besimtarët tanë mund ta porosisin kurbanin duke paguar pranë selive të Këshillave të Bashkësisë Islame në të gjitha komunat e Kosovës nëpër xhamitë tona apo edhe pranë institucioneve të tjera të Bashkësisë Islame. Bashkësia Islame e Kosovës pastaj organizon therjen e kurbanit në kohë reale duke respektuar kushtet që parasheh sheriati, si dhe kushtet higjiene-sanitare me kritere të Bashkimit Evropian. Një sasi të mishit të kurbanit, Bashkësia Islame e ndal për nevoja të medreseve tona, ndërsa pjesën tjerët ua kthen njerëzve në nevojë, pra e shpërndan tek ajo pjesë e shoqërisë që është nevojtare. Andaj, ftoj besimtarët tanë që kurbanin ta paguajnë në institucionet e Bashkësisë Islame që t'i ndihmojnë institucionet arsimore të BI-së, t'i ndihmojnë ata që kanë nevojë dhe të jenë të sigurt që kurbani i tyre do të theret në kushtet e kërkuara si të sheriatit ashtu edhe me kushte sanitare. Dua të them edhe këtë, nuk është fare e pranueshme që dikush te ne ta organizojë therjen kolektive të kurbaneve pa kushtet e parapara për trajtimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e mishit.

"Epoka e re": *Së fundi nëpër të gjitha xhamitë e Kosovës hytbet e xhumave ua kanë kushtuar ruajtjes së të rinjve nga përdorimi i lëndëve narkotike, kujdesit në trafik. Sa po ia del Bashkësia Islame e Kosovës për vetëdijesimin e shoqërisë në raport me fenomenet negative?*
Mexhidi: Është mision i komuniteteve fetare, e në këtë rast i Bashkësisë Islame, që të angazhohet që ta ruajë, ta udhëzoj dhe ta edukoj popullatën, e sidomos brezin e ri, që të mos merret me dukuri negative. Për ne është shqetësuese rritja e numrit të përdoruesve të lëndëve narkotike nga të rinjtë tanë, po ashtu është shqetësuese edhe rritja e aksidenteve me vdekshmëri në rrugët tona. Ne si Bashkësi Islame në vazhdimësi predikojmë largimin nga dukuritë negative. Këtë e bëjmë nëpër institucionet tona siç janë xhamitë, pastaj shfrytëzojmë edhe praninë tonë kudo në radhët e xhematit që të flasim për këto dukuri. Mirëpo, kryesia e BIK-ut me nismën e myftiut ka vendosur që ditë më parë kësaj çështjeje t'i kushtohet vëmendje e shtuar, duke ia dedikuar hytben e xhumasë dëmit dhe pasojave që sjellin lëndët narkotike për shoqërinë, si dhe duke apeluar në hytben tjetër për kujdes në trafik. Hytbet janë pritur mirë nga besimtarët tanë. Ne do të vazhdojmë të angazhohemi për edukimin e drejtë të të rinjve tanë. E kemi detyrë që të ruajmë e edukojmë drejt rininë dhe të ndërtojmë një shoqëri të shëndoshë, të arsimuar e të kulturuar që njeh Zotin, respekton vlerat dhe ka ndjesinë humane dhe njerëzore.

"Epoka e re": *Gjatë këtij muaji institucionet shtetërore kanë organizuar aktivitete të ndryshme për diasporën. BIK-u ka paraparë ndonjë aktivitet në këtë drejtim?*
**Mexhidi:** Ne në vazhdimësi jemi në kontakt me diasporën tonë, përmes Drejtorisë për Diasporë që vepron në kuadër të kryesisë së BIK-ut. Gjatë tërë vitit ne vizitojmë qendrat tona në diasporë, përcjellim aktivitetet, rritjen dhe sfidat e tyre. Ndërsa tani gjatë muajve të pushimeve kemi një sërë takimesh me përfaqësuesit e diasporës. Kështu, ditë më parë, në kuadër të takimit me diasporën, kryesia e BIK-ut pati një takim pune me përfaqësuesit e qendrave islame shqiptare në diasporë. Takimi është mbajtur në Medresenë e Mesme "Alaudin", ku qe i pranishëm edhe myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët. Takime të tilla kanë mbajtur edhe në nivel të Këshillave të Bashkësisë Islame.

"Epoka e re": *Cili është mesazhi i BIK-ut për qytetarët e Kosovës me rastin e kësaj feste?*
**Mexhidi:** Mesazhi i BIK-ut është: më shumë përkushtim për bamirësi, paqe, solidaritet, mbarësi dhe dashuri. Le të jetë kjo festë motiv që ta duam njëri-tjetrin më shumë, të respektojmë njëri-tjetrin më shumë, të angazhohemi për tolerancë, mirëkuptim dhe mirëbesim. Gëzuar festa!

# Rritje rekorde e stentimeve dhe koronarografive në QKUK

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 9 gusht** - Ministri i Shëndetësisë, Uran Iamaili, ka thënë të premten se shërbimet në Klinikën e Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive kanë shënuar rritje rekorde, ndërsa ajo që para dy vjetësh është dukur e pamundur, sot është bërë realitet, me vullnet dhe përkushtim të madh. "Qindra mijëra shërbime shtesë dhe dhjetëra miliona euro të shpëtuara janë rezultatet konkrete që prekin thellë në jetën e qytetarit", ka thënë Ismaili.
Në një konferencë për media, ministri Ismaili ka prezantuar të dhënat për katërfishimin e shërbimeve në Klinikën e Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive. Ai ka thënë se sistemi për stentim është funksional 24 orë, i sigurt dhe po shpëton jetë të qytetarëve të Kosovës. "Për vite me radhë në këtë shërbim kanë dalë shumë skandale që kanë dëmtuar shëndetin dhe buxhetin e qytetarëve. Krahasuar me vitet paraprake, në vitin 2019 kemi bërë 192 për qind më shumë operime kardiokirurgjike, 163 për qind më shumë stentime dhe 237 për qind më shumë koronarografi", ka theksuar ministri Ismaili, duke e konsideruar arritje më të madhe heqjen e listës së famshme të pritjes për stentim që ka lënë pacientët pa shërbime deri në dy vjet. "Falë politikave tona qytetarët marrin shërbime cilësore pa pritur dy vjet dhe me një çmim shumë të lirë. Ky është një numër rekord dhe rritje e paprecedent e vëllimit të shërbimeve: Nga 610 koronografi në vitin 2017, kemi arritur në 1451 koronarografi në vitin 2019; nga 450 stentime në vitin 2017, në 732 stentime në vitin 2019; nga 75 operime në vitin 2017, në 144 operime në vitin 2019", është shprehur ai. Ministri Ismaili ka thënë se këto statistika tregojnë se kemi krijuar modele të reja brenda sistemit shëndetësor.



## Edhe Nisma Socialdemokrate dorëzon nënshkrimet për shpërndarjen e Kuvendit

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se, sipas marrëveshjes mes partive politike, kjo parti të premten i ka dorëzuar nënshkrimet e deputetëve për mbajtjen e seancës të caktuar për 22 gusht për shpërndarjen e Kuvendit. "Në këtë seancë të fundit deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës do ta votojnë marrëveshjen ndërkombëtare të IPA-s që i sjell shtetit rreth 90 milionë euro nga BE-ja si dhe për shpërndarjen e legjislaturës së VI. Shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme, me bindje të plotë se në legjislaturën e VII Nisma Socialdemokrate do të jetë e përfaqësuar me 10+deputetë", ka thënë Sherifi. Nënshkrimet për shpërndarjen e Kuvendit i kanë dorëzuar edhe grupet parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Socialdemokrate dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.




# Ministri Gashi: Rinia, pasuria më e madhe e Kosovës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të premten në kabinetin e vet, në një ceremoni solemne, ka bërë shpërndarjen e kontratave për organizatat joqeveritare që veprojnë si ofruese të trajnimeve me projektet e tyre që kontribuojnë në rritjen e punësimit përmes ofrimit të shërbimeve cilësore për punësimin e të rinjve të moshës 18-24 vjeç. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit këtë program e ka mbështetur financiarisht me 200 mijë euro. Gjatë kësaj ceremonie ministri Gashi ka thënë se këto projekte do t'i ndihmojnë të rinjtë në fushën e punësimit përmes panaireve që do të organizohen, po ashtu, përmes promovimit dhe ndërgjegjësimit të rinisë për orientim në karrierë dhe treg të përshtatshëm të punës. "Gjithashtu programet dhe projektet që kanë për qëllim nxitjen e punësimit të të rinjve si dhe trajnimeve afatshkurta profesionale për të rinjtë", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka shtuar se është i përkushtuar që rinisë së vendit t'i ofrojë sa më shumë përkrahje në mënyrë që t'i arrijë qëllimet e veta përmes programeve të cilat i ofron ky projekt. "Ne kemi një orientim të ri sa i përket rinisë, vetëm për një qëllim, që t'i dalim në ndihmë dhe përkrahje dhe ta ndihmojmë në çështjen e punësimit sepse rinia është pasuria më e madhe e Kosovës", ka thënë ministri Gashi.






## Qalaj falënderon ambasadorin O'Connell për mbështetjen dhënë policisë

Prishtinë, 9 gusht (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka pritur të premten në një takim lamtumirës ambasadorin Ruairi O'Connell. Drejtori Qalaj e ka falënderuar ambasadorin O'Connell për mbështetjen e ofruar në të gjitha fushat për Policinë e Kosovës, ndërsa ambasadori O'Connell ka thënë se kjo mbështetje për policinë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Hoxhaj: Qytetarët e Luginës së Preshevës do ta kenë mbështetjen e institucioneve të Kosovës

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka pritur të premten në takim kryetarin e Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi, me të cilin ka diskutuar për temat që Kosova i ka prioritet: të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në Kosovën Lindore. Hoxhaj pas këtij takimi ka thënë se qytetarët e Luginës së Preshevës e kanë pasur dhe do të vazhdojnë ta kenë mbështetjen e institucioneve të Kosovës për realizimin dhe garantimin e të gjitha të drejtave të tyre. "Kosova duhet të insistojë në reciprocitet të plotë me të drejtat e pakicës serbe në Kosovë. Pa respektim të plotë të të drejtave të pakicave nuk mund të ndërtohet e ardhmja e rajonit. Qeveria e re me PDK-në do t'i shtojë kontaktet e ndërsjella dhe është e gatshme ta garantojë ndikimin e drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në Luginën e Preshevës", ka thënë Hoxhaj.



# A ka para për zgjedhje të parakohshme?


Bujar Tërstena (RFE/RL)

PRISHTINË, 9 GUSHT - Vendimi i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, që më 22 gusht të mbahet seancë për shpërndarjen e Kuvendit, u ka hapur rrugë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare pas dorëheqjes së Ramush Haradinaj nga pozita e kryeministrit. Subjektet politike në Kosovë tashmë kanë shprehur gatishmërinë për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, madje edhe kanë nisur fushatën parazgjedhore pa u caktuar zgjedhjet.

Në anën tjetër, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve thonë se ende nuk kanë para për fillimin e përgatitjeve për zgjedhje.

Valmir Elezi, zëdhënës në këtë institucion, ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se ky vit nuk ishte parashikuar si vit zgjedhor, prandaj në Ligjin e Buxhetit nuk ka mjete të planifikuara për zgjedhje. Ai ka thënë se pas shpalljes së zgjedhjeve, KQZ-ja do të bëjë kërkesë në qeveri për mjetet e nevojshme financiare.

Ndërsa sa më shpejt që do të miratohet kërkesa për mjete financiare, pas paraqitjes së saj, Elezi thotë se kjo do ta lehtësonte tej mase punën e KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve. "Zgjedhjet e kaluara parlamentare, të cilat po ashtu kanë qenë të paplanifikuara, kanë kosto të përgjithshme shumën 4 milionë euro. Por, se sa do të kushtojnë zgjedhjet eventuale ne nuk mund ta dimë tani. KQZ-ja fillon me përgatitjet intensive të një procesi zgjedhor vetëm pasi të merret vendimi për shpalljen e tij. Prandaj, në këtë drejtim ne ende nuk kemi bërë ndonjë planifikim të buxhetit" , ka thënë Elezi.

Zyrtarë të Ministrisë së Financave pohojnë se mjetet financiare për organizimin eventual të zgjedhjeve ekzistojnë në këtë ministri.

Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit në largim të Financave në Qeverinë e Kosovës, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se pas kërkesës të KQZ-së, ministria do t'i sigurojë mjetet e nevojshme. "Brenda Ministrisë së Financave janë mjetet e nevojshme për arsye se është paraparë një rezervë brenda ministrisë që të jetë në dispozicion. Pra, mjetet janë në dispozicion dhe, sipas bazës ligjore, ministri i Financave, mbi bazën e kërkesës, në këtë rast të KQZ-së, mund të bartë atë shumë të mjeteve për buxhetin e KQZ-së për të organizuar zgjedhje të jashtëzakonshme", ka deklaruar Rafuna.

Megjithatë, kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka thënë se Komisioni është i gatshëm t'i organizojë zgjedhjet kurdo që shpallen ato.

Pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës, zgjedhjet e parakohshme caktohen nga presidenti jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas shpërndarjes.

Më 10 maj të vitit 2017 një mocion mosbesimi ndaj qeverisë u miratua nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, duke i dhënë fund koalicionit të atëhershëm qeverisës dhe duke hapur rrugën drejt zgjedhjeve të parakohshme. Në atë kohë, vetëm pesë ditë (15.05.2017) pas shpërbërjes së Kuvendit, Qeveria e Kosovës në krye me ish-kryeministrin Isa Mustafa kishte arritur të ndajë rreth 5 milionë euro për KQZ-në, mjete këto të nevojshme për organizimin e zgjedhjeve më 11 qershor po të vitit 2017. Kosova, që prej shpalljes së pavarësisë së saj, nuk ka pasur një qeveri të qëndrueshme që ka përfunduar mandatin katërvjeçar.

# Gjenden 15 kilogramë marijuanë në afërsi të rrugës Gjilan - Bujanoc



PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Të premten rreth orës 8:00 Policia e Kosovës ka pranuar një informacion se në afërsi të rrugës Gjilan - Bujanoc ndodhet një çantë e zezë e cila dyshohet se ishte lënë nga persona të panjohur në një livadh (shkurre).

Me të marrë informacionin, policët nga Stacioni Policor i Kamenicës kanë dalë në vendngjarje dhe, pas veprimeve të ndërmarra, kanë konstatuar se dyshohet që në të gjenden substanca narkotike. Në këtë rast janë inkuadruar edhe hetuesit nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve në Gjilan së bashku me Forenzikën Regjionale të Gjilanit, ku pas hapjes së çantës kanë vërtetuar se në brendi kishte 31 paketime të plastikës me substancë narkotike të llojit marijuanë.

Pas verifikimit dhe aplikimit të procedurave të mëtejme është konstatuar se në atë çantë gjendeshin 31 paketime që peshonin 15 kilogramë e 215 gramë marijunë.

Në lidhje me rastin është njoftuar Prokuroria Themelore në Gjilan, ndërsa hetimet në lidhje me rastin janë duke vazhduar nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve.

## Sistemi i gjendjes civile në Komunën e Prishtinës është jashtë funksionit

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Komuna e Prishtinës përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se gjatë gjithë javës nuk ka funksionuar sistemi i gjendjes civile që menaxhohet nga Agjencia e Regjistrit Civil si pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. "Si pasojë, Zyra e Gjendjes Civile në Komunën e Prishtinës nuk ka arritur të ofrojë shërbime dhe janë krijuar radhë të gjata të pritjes. Sistemi ende nuk është rikthyer në funksion. Kërkojmë ndjesë për situatën e krijuar dhe pritjet e gjata", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



# LV-ja kërkon nga Telekomi që sa më shpejt t'i rikthejë numrat e 'Z-Mobile'-s

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje me anë të një komunikate për medie ka kërkuar nga Telekomi i Kosovës që sa më parë t'i rikthejë numrat e "Z-Mobile"-s. "Kanë kaluar nëntë ditë nga përfundimi i kontratës që Telekomi i Kosovës pati me ish 'Z-Mobile'. Brenda 30 ditëve duhet që numrat e kësaj të fundit të rikthehen aty ku e kanë vendin, pra në kompaninë mëmë, në Telekomin e Kosovës. Është e pritshme që Bordi dhe Menanxhmeti i Telekomit të Kosovës ta njoftojnë publikun se kanë marrë masat në plotni dhe se brenda 30 ditëve numrat do të kthehen nën përdorimin e Valës", është thënë në komunikatën e LV-së, duke shtuar se Autoriteti Rregullativ (ARKP), Bordi dhe zyrtarët përgjegjës, marrë parasysh ligjin dhe interesin publik, të mos krijojnë asnjë pengesë. "Opinionet a shpjegimet që dekurajojnë, relativizojnë, pengojnë, këtë proces tejet të rëndësishëm, iu shkojnë përshtat dëmtuesve të Telekomit. Çdokush që e vonon këtë proces, apo e devijon, do të jetë, pa dyshim, subjekt i proceseve të ardhshme gjyqësore, ku do




të përllogariten dëmet e shkaktuara nga kontrata dhjetëvjeçare PTK-Dardafone, në të cilën ish-anëtarët e bordeve të Rregullatorit kanë pasur rol tejet destruktiv. Numrat, pra, janë të Valës sepse abonentët që i kanë ata numra e shfrytëzojnë infrastrukturën e Valës, ndaj nuk mund të jenë të askujt tjetër përveçse të Valës. Telekomi i Kosovës duhet t'i kalojë edhe praktikisht nën administrimin e vet menjëherë e pa vonesë. Alibi procedurale dhe ligjore për pritje nuk ka", thuhet në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.



# Çekia së shpejti vjen me investime në Kosovë në fushën e teknologjisë informative

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të premten në takim pune ambasadorin e Republikës Çeke në Kosovë, Pavel Bilek, me të cilin kanë biseduar për situatën politike në vend dhe projektet ekonomike në proces. Me këtë rast, ministri Lluka është informuar nga kreu i ambasadës çeke që investimet dhe importi nga Republika Çeke janë rritur gjatë dy vjetëve të fundit, duke iu falënderuar bashkëpunimeve më të mira në mes të bizneseve nga Kosova dhe Çekia.

Ambasadori i Republikës Çeke në Kosovë, Pavel Bilek, ka theksuar se së shpejti priten që të finalizohen edhe disa investime nga ky vend, kryesisht në fushën e teknologjisë informative dhe energjisë.

Ministri Lluka gjithashtu e ka informuar ambasadorin çek për sektorët që mbulon MZhE-ja, respektivisht projektet në fushën energjetike, përfshirë legjislacionin, i cili është i favorshëm për investitorët e huaj.

Republika Çeke ka pasur një zhvillim të jashtëzakonshëm ekonomik në vitet e fundit duke e ulur papunësinë në 2.9 për qind, papunësia më e vogël e regjistruar ndonjëherë.

## Asfaltohet rruga Bukosh - Prilluzhë

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, të premten mori pjesë në fillimin e asfaltimit të rrugës Bukosh - Prilluzhë, investim i MIT-së.

Asfaltimin e kësaj rruge Kadriu e cilësoi shumë të rëndësishme, e cila ua mundëson qarkullimin tri komunave: Obiliq, Vushtrri dhe Mitrovicë, si dhe lidh 17 fshatra mes vete.

Me gjatësi mbi dymbëdhjetë kilometra, asfaltimi i rrugës Bukosh - Prilluzhë ka kosto afër dy milionë euro dhe pritet të përfundojë brenda 150 ditë pune të parapara sipas planit dinamik.

MIT tanimë është në fazën e asfaltimit të rrugëve të cilat u mundësojnë qytetarëve të Republikës së Kosovës infrastrukturë moderne dhe gjatë muajve në vazhdim pritet të fillojë edhe asfaltimi i shumë projekteve të tjera.



# Vonesat në TC 'Kosova e Re' mund të sjellin penalizime

PRISHTINË, 9 GUSHT - Projekti për Termocentralin "Kosova e Re" mund të përballet me vonesa për shkak të situatës politike në të cilën po kalon Kosova.

Shpërndarja e Kuvendit të Kosovës, e cila pritet të bëhet më 22 gusht, do ta pamundësojë miratimin e pakos financiare që nevojitet si garanci shtetërore për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e re".

Ministri në dorëheqje i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se aktualisht ky projekt nuk rrezikohet, por në rast të zvarritjes së krijimit të Kuvendit dhe qeverisë së re, atëherë do të ketë vonesa e pastaj, sipas tij, pasojnë edhe ndëshkimet financiare. "Nga ana e Kosovës janë kryer shumica e procedurave që i kemi në përgjegjësi kontraktuale, kurse jemi në pritje të një përmbylljeje financiare që duhet të bëhet nga ana e 'Contour Global'. Kjo përmbyllje financiare pasi të kryhet, shkon si paketë financiare në Kuvendin e Kosovës për aprovim. Përmbyllja e kësaj pakoje financiare, nëse nuk përket me Kuvendin e Kosovës të jetë i themeluar dhe qeveria të jetë funksionale, atëherë mund të shkaktojë vonesa nga ana jonë, por unë besoj se ka kohë dhe deri në muajin dhjetor kemi kohë që të jemi gati", ka deklaruar Lluka. Ai ka shtuar se nëse deri në dhjetor eventualisht nuk ka qeveri dhe Kuvend funksional, atëherë mund të shkaktohen vonesa nga ana e Kosovës, e cila, siç thotë ai, nuk do të ishte e mirëpritur nga asnjëra palë. Garancia shtetërore për pakon financiare për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", kërkon 2/3 e votave të deputetëve të Kosovës.

## Ndëshkimet, rreth 20 milionë euro

Qeveria e Kosovës ka nënshkruar në fund të vitit 2017 marrëveshjen komerciale me kompaninë amerikane "Contour Global", për ndërtimin e këtij termocentrali me kapacitet 500 megavat, i cili do të kushtojë 1.3 miliard euro. Ky projekt përfaqëson investimin më të madh të huaj në Kosovë. Ministri në dorëheqje, Lluka, sqaron se në bazë të kësaj kontrate, deri në muajin maj të vitit të ardhshëm të dyja palët duhet t'i përfundojnë procedurat ligjore dhe të fillojë ndërtimi i termocentralit. Por, nëse deri në atë kohë nuk arrihet të përfundohen të gjitha procedurat, shton Lluka, fillojnë ndëshkimet, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të ndodhin. "Nëse zvarritet për shkak të problemeve tona, pasojat janë që ne kemi një obligim financiar ndaj kompanisë 'Contour Global' që është 19.7 milionë euro, nëse ne i përfundojmë obligimet, por 'Contour Global' nuk arrin të sigurojë pakon financiare, atëherë i detyrohet Kosovës një vlerë prej 17.5 milionë eurosh", ka shpjeguar Lluka.

Në anën tjetër, përfaqësues të bizneseve thonë se ekonomia e Kosovës dhe projektet kapitale në vazhdimësi po pengohen nga ciklet e shpeshta të zgjedhjeve, në të cilat vendi ka kaluar në vitet e fundit.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se është e rëndësishme që projekti i termocentralit të mos ketë vonesa në procedura edhe për shkak të penalizimeve, por edhe për shkak të investimit. "Termocentrali 'Kosova e Re' është një ndër projektet e vetme që është në pritje për investime më të mëdha në Kosovë dhe, si i tillë, është i rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë për investime në vend dhe në të njëjtën kohë për pritjen e investimeve të tjera që mund të pasonin qoftë nga rritja e besimit, qoftë nga infrastruktura, pasi e dimë se kemi probleme të vazhdueshme me energji elektrike. Është një mundësi e fundit për të nxitur investime. Ne presim një kuvend të ri, i cili shpresojmë të jetë më efikas sesa Kuvendi që ka qenë deri tani, e i cili është në prag të shpërndarjes", ka thënë Rukiqi.

Termocentrali "Kosova e Re" ishte paraparë të fillohet të ndërtohet në këtë vit, ndërsa të vihet në punë në vitin 2023. Jetëgjatësia e termocentralit "Kosova e Re" është llogaritur të jetë 40 vjet. Termocentrali "Kosova e Re" është kundërshtuar nga disa përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët e konsiderojnë si një projekt të dëmshëm për mjedisin dhe qytetarët. Kosova ka më shumë se 10 miliardë tonë linjit dhe, si i tillë, është vendi i pestë në botë për nga sasia e këtij resursi, por me gjithë pasurinë e linjitit, Kosova vazhdon të përballet me mungesë të energjisë elektrike.



## ATK-ja ka bërë tërheqjen e numrave potencialë fitues nga grumbullimi i kuponëve fiskalë

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka bërë tërheqjen e numrave potencialë fitues për rimbursim të qytetarëve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë për periudhën e tremujorit të dytë (TM2) 2019. "Qytetarët të cilët kanë numrin potencial fitues të përzgjedhur nga tërheqja, plikon me kuponë fiskal së bashku me të dhënat e aplikimit duhet ta dorëzojnë fizikisht të mbyllur, në njërën nga drejtoritë regjionale të ATK-së, brenda afatit prej pesë ditë pune pas publikimit të listës në uebfaqe të ATK-së. Dorëzimi i plikove duhet të bëhet nga data 13 gusht deri më 19 gusht (përveç fundjavës), nga ora 08:00 deri në orën16:00", thuhet në njoftimin e ATK-së, duke theksuar se të gjithë qytetarët që janë shpallur fitues t'i verifikojnë llogaritë e tyre bankare dhe të sigurohen se ato llogari janë funksionale dhe mund të kreditohen nga ATK-ja, në të kundërtën ATK-ja nuk do të marrë asnjë përgjegjësi nëse llogaria bankare është jofunksionale.



## Komuna e Skenderajt nënshkruan kontratat me 18 përfituesit e serrave



SKENDERAJ, 9 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se të premten kanë nënshkruar kontratat me 18 përfituesit e serrave, përmes Drejtorisë së Bujqësisë. "Ky është edhe një hap i dëshmuar për t'i ndihmuar dhe mbështetur bujqit tanë. Bujqësia është prioriteti ynë dhe gjithmonë do të jemi pranë bujqve punëtorë!", ka thënë kryetari Jashari pas nënshkrimit të këtyre kontratave.

# Arrestohen tre persona të dyshuar për 'grabitje me armë' në Raushiq të Pejës

PEJË, 9 GUSHT (ER) - Më 3 gusht në fshatin Raushiq të Pejës pati ndodhur një 'grabitje e armatosur'. Policia e Kosovës me të marrë informatën ka shkuar në vendngjarje. Sipas viktimës, derisa ishte duke udhëtuar me veturë, e ka vërejtur një pengesë në rrugë. I njëjti ka ndaluar për ta larguar pengesën, por aty kanë dalë të dyshuarit, e njëri nga ta kishte një armë në dorë dhe nën kanosje ka grabitur çantën në të cilën gjendeshin të holla rreth 226 euro dhe 100 franga, duke u larguar në drejtim të panjohur.
Sipas policisë, viktima e rastit është goditur disa herë nga të dyshuarit, ka pranuar tretman mjekësor dhe, sipas mjekut, ka pësuar lëndime të lehta. "Policia e Kosovës, Njësiti Rajonal i Grabitjeve, pas një pune intensive operativo-hetimore më 8 gusht ka arritur që të identifikojë dhe më pas të arrestojë tre persona të dyshuar për 'grabitje të armatosur'. Nga këta dy persona janë të mitur. Me vendim të prokurorit të shtetit ndaj të dyshuarve është caktuar masa e ndalimit policor prej 48 orëve dhe për personin e mitur 24 orë, ndërsa për njërin nga personat e mitur është liruar në procedurë të rregullt, për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



# Po vazhdon mbajtja e debateve në Malishevë për projektbuxhetin



MALISHEVË, 9 GUSHT (ER) - Në kuadër të hartimit të projektbuxhetit 2020-2022 për Komunën e Malishevës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), kanë vazhduar mbajtjen e takimeve në fshatra dhe vendbanime, me qëllim të njoftimit me prioritetet apo kërkesat e qytetarëve për investime në vitet në vijim.
Takimet janë mbajtur në fshatrat Vërmicë dhe Turjakë. Sipas drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, në këto takime, paraprakisht, qytetarët njoftohen me qëllimin e takimit, ndërsa u sqarohet në vija të trasha edhe buxheti, me theks të veçantë për vitin 2020. Sipas tij, qëllim i këtyre takimeve është që buxheti të hartohet duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve. "Përmes këtyre takimeve ne jemi duke i marrë kërkesat apo nevojat që kanë banorët e Vërmicës dhe Turjakës, ndërsa kështu do të vazhdohet në të gjitha vendbanimet e komunës së Malishevës dhe përmes këtyre kërkesave, ne do t'i orientojmë prioritetet në hartimin e buxhetit, përkatësisht hartimin e listës së projekteve kapitale, apo planifikimin e investimeve për vitet në vijim", ka thënë drejtori Mazreku.
Kërkesat e banorëve kryesisht janë për vazhdimin e rregullimit të infrastrukturës në përgjithësi, si ujësjellës, rrjete kanalizimi dhe infrastrukturë tjetër, përmes së cilës përmirësohet jetesa dhe mirëqenia e banorëve në vendet ku ata jetojnë.

# Ahmeti dhe Matoshi inspektojnë punimet për rregullimin e shtratit të lumit Sitnica

LIPJAN, 9 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, kanë vizituar punimet që janë duke u bërë në rregullimin e shtratit të lumit Sitnica dhe ndërtimin e shtratit të lumit Janjevë. Po ashtu, Ahmeti dhe Matoshi kanë bërë përurimin e fillimit të punimeve për projektin "Pastrimi i shtratit të lumit Sllovi-Lipjan".
I pari i Lipjanit ka thënë se investimet e tilla janë shumë të mirëseardhura. "Këto investime i mirëpret Komuna



e Lipjanit dhe do të qëndrojmë mbrapa çdo pengese eventuale të cilat mund të hasen gjatë implementimit të këtyre projekteve", ka thënë kryetari Ahmeti, i cili me Matoshi janë marrë vesh që së bashku ta bëjnë inspektimin e punimeve deri në finalizimin e tyre.

## Në Savrovë të Suharekës po rregullohen rrugët lokale

SUHAREKË, 9 GUSHT (ER) - Në fshatin Savrovë të Komunës së Suharekës janë duke u rregulluar rrugët lokale. Punimet në rregullimin e këtyre rrugëve ka shkruar për t'i parë nga afër të premten kryetari i komunës Bali Muharremaj, së bashku me stafin e tij, i cili gjatë takimit me banorët gjatë punimeve ka thënë se puna nuk do të ndalet deri në realizimin e projektit. Ai ka thënë se si kryetar komune do të angazhohet që t'u ofrohet qytetarëve infrastrukturë e mirë rrugore.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (15)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

Në emër të Qendrës së LVV - Malishevë, shprehim ngushëllimet më të sinqerta për Bacën, Adem Demaçi, familjes Demaçi dhe gjithë atdhetarëve shqiptar!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Në emër të Qendrës së LDK-së, i shprehim ngushëllime familjes së atdhetarit të madh të kombit shqiptar, Adem Demaçi, me rastin e ndarjes së Bacës nga jeta! Baca, Adem tërë jetën ia kushtoi çështjes kombëtare dhe lirisë së popullit shqiptar. Lavdi jetës dhe veprës së Mendeles së Ballkanit. I lehtë të qoftë dheu i Kosovës, o Baca Adem!

29 korrik 2018,
K. D.

Vëllai Ademi, na mësoi se si duhet ta duam Atdheun!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Bacë, Adem, o frymëzuesi ynë, lamtumirë!

29 korrik 2018,
Hamdi Zymberi

I lehtë të qoftë dheu i Kosovës, o Baca Adem. Zoti të shpërbleftë për atë që ke bërë!

29 korrik 2018,
Daut Shaqiri, Tetovë

Adem Demaçi njeriu i pavdekshëm për të gjitha brezat - Lavdi!

29 korrik 2018,
Beqir Beqiri, Ferizaj

Baca Adem, mbetet vizionar dhe feniks për shqiptarët! Lavdi!

29 korrik 2018,
Sylejman Gashi, Podujevë

Me respekt Bacë! Kemi pasur nderin të të njohim! Pastë shpërblimin edhe në xhenet!

29 korrik 2018,
Rexhep Hoxha

Ti u dogje vetëm, duke u bërë dritë për ne! Nuk do të ketë edhe një më sikur Ti! Lavdi e përjetshme!

29 korrik 2018,
Erleta Xhemajli, Ferizaj

Është vështirë me gjete fjalë për ta përshkruar personalitetin Tënd, o Bacë! Perëndia e mëshiroftë shpirtin Tënd dhe të dhuroftë xhenetin.
Mos u harroftë kurrë ideali dhe vepra Jote sa të ekzistojë Kombi shqiptar! Lavdi jetës dhe veprës Tënde. Të përkulemi me dinjitet!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Është vështirë të ndahemi prej Teje, Baca Adem! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës të cilën e deshe aq shumë!

29 korrik 2018,
Ismet Mehmeti

Baca Adem, të kujton Hasan Dumani, i burgosuri politik së bashku me Juve!

29 korrik 2018,
Hasan Dumani

Baca Adem, Ju përkujton me respekti i biri i Hasan Dumanit. Lavdi të qoftë për jetë e mot!

29 korrik 2018,
Skënder Dumani

Me Ty krenohemi deri në frymën e fundit, Baca Adem! Do të përkujtojmë çdo herë me respekt!

29 korrik 2018,
S. Kastrati

Në emër të familjes së Rexhep Elmazit, iu shprehim ngushëllime të sinqerta e respekt, familjes Demaçi, për veprën kombëtare të Kolosit shqiptar Adem Demaçi!

29 korrik 2018,
Familja Elmazi

Baca Adem, e shkrove historinë, me shkronja të arta për shqiptarizmin! Idetë tuaja Revolucionare duhet t'i kemi në krye të çdo veprimi e situate. Lavdi jetës dhe veprës Tënde!

29 korrik 2018,
Arben dhe Ibadete Limani, Gjilan

Simboli i Luftës për çështjen kombëtare, baca Adem, Do të jetoj në zemrat e gjithë shqiptarëve!

29 korrik 2018,
Naim Gashi, Drenas

Sa e pafuqishme vdekja përballë lavdisë Tënde, Baca Adem!

29 korrik 2018,
Burim Krasniqi

Krenaria për veprën Tënde të madhe, Baca Adem, e mund dhembjen tonë për vdekjen! Lavdi të qoftë, Bacë!

29 korrik 2018,
Hysen Sylejmani, Gani Loshi

Prehu në paqe, Bacë! Të qoftë i lehtë dheu, Nderi i Kombit!

29 korrik 2018,
Xheladin Tafallari, Shoq. Çamëria, Prizren


Bacë!
Atë që gjarpërit e gjakut nuk mundën ta bëjn, ta bën varrat e zi. Por ti je i pavdekshëm në zemrat e popullit dhe patriotve.
Behare Rexhepi

*Faksimil i përshtypjes të Behare Rexhepit, bashkëveprimtare e Adem Demaçit*



Baca Adem, gjithmonë do të mbetesh simbol i lirisë së Kombit shqiptar! Lavdi!

29 korrik 2018,
Shefqet Bruçaj, Prizren

O Baca Adem, Ti je i popullit, Ti je në mesin e të gjithë atyre që deshtë dhe të deshën, Ti je i gjallë! Për Ty nuk ka vdekje! Me vdekjen Tënde, vepra do ta ruaj lavdinë e përjetshme!

29 korrik 2018,
Faridin Tafallari

Humbje e madhe e njeriut të dëshmuar atdhetar, patriot e mbi të gjitha liridashës!

29 korrik 2018,
Ridvan Pakashtica

I qoftë i lehtë dheu i Kosovës! Vepra e Juaj, baca Adem, do të jetojë përherë!

29 korrik 2018,
Mirjeta Behluli

Ishe dhe do të mbetesh rreze drite për Lirinë e Kosovës, për ata që dinë të vlerësojnë çka është Liria!

29 korrik 2018,
Sanije Derguti

Të patëm frymëzim, të patëm udhërrëfyes, do të mbetesh idhulli Ynë! Faleminderit pafundësisht për të gjitha që bërë. Pafundësisht të faleminderit edhe për mundësinë që pata që të jem një shokë i Yti, ishte privilegj njohja me Ty. Me respekt, siç kisha qejf të më quaje; Aga Cenë!

29 korrik 2018,
Hysen Shurdhani

Nga një emër i thjesht e more emrin Ideal!
Ideal, për mua, familjen time, për Drenicën, për Shqipërinë. Për të gjitha Trojet tona me një ëndërr për t'u bashkuar një herë e përgjithmonë në një shtet. Nderime i madhi, bacë Adem Demaçi! Gjithmonë do të jesh, në zemrat tona dhe në mendjen tonë, baca Adem! Respekt nga zemra!

29 korrik 2018,
Dr. Sadik Murati, Skenderaj

Vje?na ti slava, veliki borac za svoj narod; borac za ljudska prava!

29 Juli 2018,
Safet Karad-, Prizren

Lavdi Bacës Adem! Do të mbetesh i pavdekshëm brez pas brezi e shekull pas shekulli!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem Demaçi,
U rritem, u frymëzuam, u edukuam, morëm energji dhe u motivuam për përpjekje, angazhim, veprim e luftë për çlirimin e tokave të pushtuara Të Shqipërisë! Edhe atëherë kur Ti ishe i mbyllur prapa shtatë drynave të pushtuesit, ishe udhërrëfyesi dhe udhëheqësi ynë shpirtëror e politik... Të bacë, nuk u theve, nuk u mposhte dhe nuk u dorëzove kurrë para pushtuesit. Me jetën dhe veprën Tënde u bëre krenaria dhe mbrojtja e Shqipërisë dhe e kombit shqiptar!.. Me ty Bacë, u koritëm për të gjallë e të vdekur institucionet "shtetërore" të Kosovës!
I përjetshëm qoftë kujtimi dhe nderimi Yt!

29 korrik 2018,
Xhevat Bislimi

Kjo fotografi me buzëqeshjen Tënde është dhuntia jote që e pate në jetën që kalove, por, ne shqiptarët i rritem fëmijët tanë me fjalët e synimet Tuaja! Respekt!

29 korrik 2018,
Mirishahe Haziraj, Prishtinë

Pusho në paqe, njeri i mirë!

29 korrik 2018,
N. Jaha

Pusho në paqe, e të jemi mirënjohës përjetësisht për veprën tuaj, për lirinë e Kosovës! Mbetesh frymëzim i gjeneratave që vijnë!

29 korrik 2018,
Arber Mulaku

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


Me Fat
Kurban Bajrami!
PRISHTINA INTERNATIONAL AIRPORT ADEM JASHARI
Limak
KOSOVO


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E rrallë

# Cigarja elektrike gati ia mori jetën 18-vjeçarit



Një student 18-vjeçar ka zbuluar dëmet që i shkaktuan kimikatet toksike të cigares elektronike. Javën e kaluar Chance Ammirata rrëfen se pa "vdekjen me sy" për shkak të pajisjes, të cilën e mendonte të sigurt. Chance konsumonte rreth një "Juul" çdo dy ditë, i cili ka nikotinë sa dhjetë cigare. E gjitha kjo bëri që studenti të përfundonte në spital në gjendje të rëndë. Duroi të gjitha dhimbjet për plot pesë orë dhe kur mbërriti në spital, e rrethuan shtatë kirurgë. Tani Chance është mirë.

FOTO E DITES



Të premten kanë dhanë betimin solemn për shërbim në FSK 349 rekrutë të rinj, pas përfundimit të trajnimit bazik nëntëjavësh në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj.

E jashtëzakonshme

# 400 euro për t'u ulur në shkallët e Piazza di Spagna



Kushdo që ka vizituar Romën është ndalur pa dyshim në Piaza di Spagna. 135 shkallët e saj janë një atraksion i famshëm turistik e thuajse çdo vizitor i Romës ka provuar të ulet mbi to. Por nëse do të duhet ta provoni sërish, bëjini llogaritë mirë. Kushdo që do të ulet në këto shkallë që zbresin nga kisha "Trinita de' Monti", do të duhet të paguajë 400 euro, një çmim edhe më i shtrenjtë se një biletë në teatrin e famshëm "La Scala".

## BARSOLETA E DITËS



**Polici dhe konserva:**
**Një burrë kishte probleme ta hapte konservën e peshkut. Aty kalon një polic dhe e kërkon ndihmën e tij. Polici me mirësjellje i thotë: - E hap unë. E merr konservën dhe troket mbi të: - Tak- tak, hapu se është policia!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Çdo ditë në ora 15:30**

**"Spider-Man Far From Home" 3D,**




Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts




**Çdo ditë në ora 17:30**

**"THE LION KING" 3D**

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

**Rolet:** Donald Glover,Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
**Regjia:** Jon Favreau

**Në ora 19:30 dhe 22:00**

**"HOBBS & SHAW"**




Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
**Regjia:** David Leitchu




**Nga dt. 08.08.2019**

**"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

**Regjia:** Thurop Van Orman

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot mund të ndiheni shumë të kënaqur nga arritjet e projekteve tuaja. Keni ditur se si të kombinoni idetë me praktiken në punë.



**DEMI**
Po ecni me hapa të avashtë sa i përket çështjeve të zemrës. Çdo gjë rreth e qark po ju flet për situata të reja.



**BINJAKËT**
Dita do të nisë me një lajm që si fillim mund t'ju çorientojë disi, por që do të jetë mjaft optimist për të ardhmen.



**GAFORRJA**
Keni preferuar që të jeni të drejtpërdrejtë me njerëzit sot, por kjo gjë do të lëkundë ndjeshëm raportet tuaja me kolegët.



**LUANI**
Sot jeni të pavendosur lidhur me çfarë do të bëni. Kjo gjë vjen për shkak të mos njohjes së personave që do të keni përballë gjatë ditës.



**VIRGJERESHA**
Ndonjëherë mund të veproni edhe pa marrë miratimin e të tjerëve. Nëse vendosni të silleni në një mënyrë të caktuar sot, ndajeni mendjen me veten tuaj.



**PESHORJA**
Po vini në provë personat që keni pranë për të parë nëse janë në sintoni me ato që ju mendoni. Sot do të keni një surprizë të këndshme.



**AKREPI**
Ndonjëherë provoni të dëgjoni edhe ata që ju japin këshilla. Jo gjithmonë keni ju të drejtë për gjithçka.



**SHIGJETARI**
Po bëni gjithçka që të mos tregoni shqetësimin që ju ka shkaktuar një lajm që sapo dëgjuat. Nëse duhet të veproni duhet ta bëni tani.



**BRICJAPI**
Të gjithë do të mundohen t'ju kënaqin sot. Është një ditë e veçantë për ju dhe kjo gjë ju bën të ndiheni të përkëdhelur.



**UJORI**
Po mundoheni të modifikoni planet tuaja për të ardhmen sepse keni kuptuar që janë shumë më ambiciozë se sa mundësitë tuaja reale.



**PESHQIT**
Dita sot do të ndryshojë komplet nga ajo që ju kishit parashikuar. E rëndësishme është të mos ju kapë paniku.

# Pas koncertit në Prishtinë, Miley Cyrus shtrohet në psikiatri



Katër ditë pasi ka performuar në festivalin "Sunny Hill" në Prishtinë, mësohet se artistja Miley Cyrus është shtruar në një klinikë psikiatrike. Sipas mediave të huaja, shtrimi i këngëtares është bërë për të përmirësuar gjendjen e saj psikologjike si dhe për t'ia shpëtuar martesën. Thuhet se familjarët e kanë bindur këngëtaren që të marrë trajtimin e duhur edhe sepse kohët e fundit, ajo dhe aktori Liam Hemsworth kanë patsr shumë probleme në çift.

# Rick Ross rikthehet me album



Reperi 43-vjeçar Rick Ross ka publikuar albumin e tij të nëntë me emrin "Port of Miami 2". Ky është vazhdimi i albumit të tij debutues "Port of Miami", të cilin e kishte publikuar në vitin 2006. Për këtë projekt muzikor ai ka bashkëpunuar me shumë miq të njohur, përfshirë Meek Mill, Drake dhe Nipsey Hussle.



# Kylie Jenner mbërrin në Itali për të festuar ditëlindjen e saj

Ylli dhe biznesmenja e famshme, Kylie Jenner, ka mbërri në Itali bashkë me familjen dhe shoqërinë e saj. Jenner është në Itali për të festuar ditëlindjen e 22-të, e cila do që ditëlindjen e saj ta organizojë në një jaht privat, i cili raportohet se vlen 250 milionë dollarë. Jahti përmban një staf prej 29 personash dhe kushton 1.2 milion dollarë në javë me qira.

# Frymëmarrja detyron Nelson ta anulojë turneun



Billie Nelson ka anuluar turneun. Muzikanti 86-vjeçar ka njoftuar fansat me anë të një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". "I njoftoj fansat e mi se me keqardhje më duhet ta anuloj turneun sepse kam probleme me frymëmarrje dhe kam nevojë që doktori im të më mjekojë. Do të rikthehem", ka shkruar ai. Pas publikimit të albumit të tij të 69-të me radhë Ride Me Back Home në fillim të vitit, legjenda e muzikës country e kishte planifikuar të nisej për në turneun e madh ku përfshihej Nju Jork, Virginia dhe Cincinati. Para këtij njoftimi ai i kishte të planifikuara edhe përafërsisht 30 performanca.

# FUQIA E POPULLIT TË ROBËRUAR QË IA THEU KURRIZIN ROBËRISË SERBE NË KOSOVË NË BALLË ME UÇK-në

*(Gani Sylaj, "Ilegal viteve shtatëdhjetë", Prishtinë, 2018)*



**Prof. dr. Hakif BAJRAMI**

Mësuesi i muzikës që u bë dirigjent i politikës ilegale, por edhe mjeshtër i përdorimit të armës në radhët e para të UÇK-së së Adem Jasharit - legjendarit. Me këtë libër na shfaqet kryengritës i vërtetë në gjatësi, patriot në lartësi dhe veprimtar në gjerësi, që i thotë robërisë largohu ose do të vrasë, pa mëshirë sepse çlirimi i popullit tim është më i shtrenjtë se jeta ime, çlirimi i tokave të popullit tim ka çmim të cilin jam gati ta paguaj me jetë e gjak, me barot lirie.

Monografia e Gani Sylajt ka një kompozicion standard shkollor publicistiko-historik dhe argumentues për çdo hulumtues të rrugës së çlirimit Kosovës. Me një parathënie, hyrje dhe tekst themelor, autori rezulton se ka hyrë në rrugën e drejtë të kombit, si nxënës i denjë i shkollës emblematike të Adem Demaçit. Natyrshëm, argumentimin e vet e fillon nga organizimi ilegal politik me shokët e një ideali si: Mehmet Hajrizi, Kadri Osamni, Xhafer Shatri, Mustafë Ademi etj. Kështu duke e filluar luftën ilegale më 1971, Gani Sylaj nuk i numëron hapat, por i renditë vitet e robërisë për ta pasur gjithmonë familjen shtyllë dinamike në plagët e historisë, të cilat e vizatojnë me vrragët e tyre paralajmërimin e epokës së Adem Jasharit.

Jorastësisht këto vrragë historie nuk mund të hekuroseshin, t'u gjendet fytyra e tyre e vërtetë, pa arsimim shkollor dhe politik. Në librin e Gani Sylajt e kuptoi si hulumtues i vjetër një porosi faktografike se okupator del sheshazi se ishte Serbia e avancuar në Jugosllavi. Në të dhe për të, shqiptarët del se ishin më të interesuarit t'ia kthejnë kokën teposhtë, me mjete politike në fillim, e kur të sosen ato mjete, me ia kris edhe pushkën. Në këtë drejtim kur filloi përmbysja e Jugosllavisë (Serbisë) del se kroatët janë me shqiptarët, ndërsa bullgarët patën thënë na e dërgoni një "selam". Ndërsa boshnjakët si gjithmonë do të na thonë, po mendojmë për juve, duke na vënë thikë pas shpinës.

## Edhe në fëmijëri jeta e jetuar për Gani Sylën, gatitu ndaj porosive të nënës

Është kënaqësi dhe krenari për çdo lexues dhe studiues, kur e sheh të vizatuar dhe të përshkruar jetën e heronjve tanë të aksionit, të burgut dhe të luftës, se si e respektojnë nënën, babën, të afërmit, sidomos nxënësit patriotë. Është krenari kulmore kur nga kjo shkollë edukimi krijohen shoqëri kudo atdhetare në shkollë, studime, në aksione dhe në luftë, duke e peshuar gjithmonë modestinë dhe trimërinë e Ahmet Delisë me moton: "Unë luftoj me ato mjete që i kam, por do të luftoj t'i ndryshojë shekujt, mjetet e luftës dhe do të fitoj me siguri, sepse askund nuk e urrej, por e dua shqiptarinë, atdheun më shumë se jetën'.

Po, në këto rrethana ora e Gani Sylajt rrah sigurt, por ngadalë, madje më ngadalë se kudo në Evropë sepse hapërimi ynë është me peshë të madhe plagësh, që na i ka vënë në kurriz robëria e okupatorit. E për Gani Sylën dhe shoqërinë e tij nuk ka peshë robërie që i ndal rrezet e lirisë, nuk ka barrikadë që e shkëputë rrugën e vështirë por të pathyer, para grushtit të këtij revolucionari dhe patrioti. Prandaj Gani Sylaj do ta këndojë në çdo kohë prejse u bë, për të menduar logjikshëm, për të folur si burrë i pjekur, për të vepruar si i burrëruar para kohe:

O Kosovë e tokë bekue,
Ku gjallnue kanë dymbdhjet fise,
E Shqipnisë ma e bukur hise,
Gjithë për ty zemra më gufon,
S'është shqiptar ai që ty të harron!

Duke lexuar librin e Gani Syajt në shikim të parë del se jeta e jetuar është fare e thjeshtë, por duke u thelluar në kuptimin e asaj jete, të atij aktiviteti politik revolucionar, me premise të pamposhtura kombëtare me shokë shumë, që e krijojnë historinë, historia e krijuar nga Gani Sylaj dhe shokët e tij, historia vizatohet se është shumë e komplikuar, shumë e vuajtur, e historia e vuajtur dihet se nuk ka "dhimbje", por ka plagë që ia rëndojnë kurrizin, sepse dhimbja që nuk dhemb nuk është me aromë kombëtare njerëzore për Gani Sylën e ilegales.

Gati në tërësi personazhet e Gani Sylës sot janë heronj të gjallë me të cilët ka krijuar jetë begatie familjare dhe kombëtare dhe ky heroizëm permanent në luftë të pandërprerë, do të mbetej në gjysmë të rrugës po mos të shkrepej pushka e lirisë dhe çlirimit në Drenicën e tij, në Kosovën e tyre. Kështu të kuptuar personazhet e Gani Sylës sot janë edhe ndër komandantët drejtues të UÇK-së, janë edukatorë, arsimtarë, shkencëtarë, politikanë që drejtojnë shtetin më të ri në Evropë e që ka historinë më të vjetër në kontinent. Dhe shtrohet pyetja helmetiane, kush u ka besuar atëherë kur i filluan hapat e parë personazheve të Gani Sylës, se këta të ilegales do të përmbysin atë shtet dhe do të ndërtojnë shtet që i ka rrënjët në trakte, gazeta ilegale të kazmës dhe çekanit, burgut dhe shërbimit ushtarak, sa për ta la një obligim që nuk konsiderohej obligim, por dënim, se bëhej për përdorim të skaduar, të imponuar.

Burgosjet e vitit 1974 janë një paralajmërim se pushteti "do të shkojë deri në fund", kundër patriotëve që nuk flenë. Dhe kur e analizojmë këtë fenomen, kur ia vejmë në kurriz shembjen e shtetit katrahurë (Jugosllavi), kur i grumbullojmë mjetet me çka synohej shembja, kur e dimë se gati të gjithë mendonin "kuq e zi", por që yllin e kishin kapak, atëherë tregimi i Gani Sylës del se është një filozofi jetësore e Johan Keplerit: "Çdo gjë sillet në rrugë ekliptike dhe në qendër të sjelljes është ndryshimi", është përshtatja ngadalë, por sigurt nga hedhja e trakteve, nga shpërthimi në demonstrata në zakone të luftës armatosur, sepse heronjtë e trakteve, kreatorë të demonstratave (1968-1981…), edhe atëherë i ke arsimtarë e gazetarë, informatorë e veprimtarë, që më shumë kah vitet '90-ta të shekullit XX i afrohen pushkës, duke u larguar ngadalë jorealitetit që e kishin mësuar, por donin realitetin ta transformojnë në gjakun e njomë të heronjve të ardhmërisë, pra jo të ditës, jo të grupit, por të armës dhe istikamit, prej të cilave okupatori nxiton të përfitojë sa më shumë se po e mbron shtetin dhe me këtë filozofi do ta ketë të drejtën bllanko nga ndërkombëtarët, sikurse në kohën e ilegales, në kohën e flamujve dhe trakteve, të cilët në pranverën e tyre e kishin të njëjtin efekt, të njëjtën energji, sepse edhe me ato mjete modeste synohej transformimi rrënjësor i tërë godinës politike dhe shtetërore të shoqërisë. Por transformimi nga lufta qytetare paqësore në luftë me armë ishte një rrugë serioze dhe me shumë përgjegjësi, por as ajo e para (rrugë) as kjo e dyta (luftë) nuk do të kryenin punë me sukses po mos t'i kishte personazhet e pashkëputur nga puna, simbolikisht me Gani Sylajn si akter aktiv dhe i pathyeshëm, sepse vepron me besën e nënës, sepse vepron me shkollën e Adem Demaçit, sepse simbolizon tërë punën dhe luftën me shokët e idealit, prej të cilëve nuk ndahet me asnjë çmim.

Libri i Gani Sylës nuk është monografi e brengës së individit, por është shkollë e luftës, e vetëflijimit. Kështu për ta fituar informatën si fuqi prodhuese historike, Gani Syla dhe "Komiteti" i tij nuk zgjedhin mjete, madje shokun më të ngushtë e dërgojnë të punojë aty (në SPB), ku këtyre u përgatitet vdekja, për ta kuptuar se duhet të vdesin shumë më pak kur i kanë informatat e armikut, përmes shokut tyre.

Gani Sylaj e dinte si personalitet i pjekur se lufta çlirimtare nuk është paradë. Kjo luftë është bërë gjithmonë herë me dinakëri, mençuri dhe trimëri, edhe me frikë edhe me fytyrë besa në raste të rralla edhe pa të, por një aksiomë Gani Syla dhe shokët e tij e dinin se shkolla kombëtare e Adem Demaçit nuk ka mbarim deri në fitore të sigurt, sepse bazohej në të kaluarën e ndritur të luftërave, të cilat për kohën dhe rrethanat e veta ishin po aq të ndritshme ashtu si ato të fundit të shekullit XX, sepse synimi ishte i njëjtë. Dhe kur të krahasohen këto gjenerata, lavdi tërë historisë patriotike para tyre, por duhet thënë se nuk na është sjell liria. E gjenerata e Gani Sylajt e ka një përparësi krahasimisht ma famëlartë se për herë të parë lufta dhe çlirimi e kanë një vlerë, e kanë pavarësinë e Kosovës. E kur e themi këtë e shtrojmë pyetjen se gjenerata e mëparshme a i kishte luftëtarët e denjë dhe drejtuesit e dinjitetshëm, përgjigja është se po. Po, larinë nuk na e sollën. E gjenerata e 1968-1981-1999 me që e kishte drejtuesin legjendar Adem Demaçin, plus 'ushtarët' shumëfish ma të shkolluar, e këtu diku duhet gjetur çelësin e fitores, sepse u rreshtuam kah duhet, kah ShBA dhe NATO, me përkushtim.

Modestia e Gani Sylës mendon dhe flet se kjo shkollë i ka rrënjët e shëndosha ku të këshillon nëna, me shokë, me mësues me rini të dy gjinive, sepse Ganiu i do të dy duart, në luftën e shpallur politika e cila e përgatiti dhe e ktheu në kala luftën ushtarake krismën e pushkës, së cilës Gani Sylaj i takoi nga ditët e para.

Gani Sylaj i burgut, i vizatimit dhe i mësuesit të historisë, i mendimit kolektiv si Rexhep Mala, si Azem Syla e Jakup Krasniqi, Hydajet Hyseni me shokë shumë që janë ajka e një gjenerate që për herë të pare në histori e krijojnë një shtet me fuqinë e pushkës, të diplomacie dhe pastërtisë në aksione politike në proces. Kështu, si e kanë projektuar dhe realizuar Epokën e Adem Demaçit, kjo shkollë nuk ndryshon nga të tjerat, por me efektivitetin e saj, na del me argumente se as nuk e kemi konsumuar njësoj, as nuk i kemi rezervuar kohë dhe përpjekje si komb i tërë që ta kultivojmë ngjashëm, sepse kemi pasur sabotues e mercenarë të mesit tonë, të gjakut tonë, të cilët gati janë njësoj si okupatori, sepse i kemi pasur pranë dhe na kanë penguar, për të mos thënë luftuar, deri edhe me fuqinë e armës politike dhe ushtarake. Kështu, lidhur me potencialin mobilizues, mu pse nuk ishin të gjithë të një rreshtimi për luftë del se nuk kemi ndërtuar themel aq të forte të shtetit të sotëm, mu nga shkaku se globalisht nuk kemi qëndruar të gjithë vertikalisht ashtu si e kërkonte koha dhe nevoja kombëtare, si na ftonte zëri e atdheut, si na ftonte pushka e Adem Shaban Jasharit.

Përvoja që mbjell në zgjimin kombëtar, shkolla e Gani Sylës, të rreshton ngadalë por sigurt kah altari prej të cilit ma nuk mund të ndahesh deri sa të gjen fitorja ose vdekja gatitu pranë Flamurit të luftës. Po kjo shkollë e Gani Sylës është skalitë në libër si një kala me dy porta: ose e ke fitoren ose e ke vdekjen përpara. Por në luftën

→

e Gani Sylës, prapë të tjerët pas teje fitojnë sepse lufta është e drejtë, është politike, por edhe i hap rrugë Epokës së pushkës. Lidhur me këtë filozofi shumë e thjeshtuar, por më shumë e komplikuar, sepse nuk jemi të gjithë të një bese, sepse dikush ende ma tepër I beson fjalës boshe por premtuese, se sa vargonjve të gjakut që janë garanci e çlirimit, janë shkollë e re që quhet neoluftë, që nuk vret civilë të shtetit robërues. Pra gjenerata e Gani Sylës është fituese e dyfishtë, fituese e lirisë, fituese e luftës që për here të pare në histori mbaron me faktin se i "forti" humb.

Në librin e Gani Sylës fol oda, nëna dhe rrudhat në fytyrë të babait dhe atyre që e kishin mbi supe peshën e shumë vuajtjeve, që jo me fajin e tyre por me forcën e fuçive ua kishin plasuar robërinë në votër dhe tash për të satën herë jo që provonin por alarmonin opinionin botëror se ja ku jemi, nuk kemi ku të shkojmë përpos që të mbrohemi për të jetuar në vatrat tona den baba den. Dhe lufta jonë është e një shkolle të paparë në histori, sepse nuk vret fëmijë, gra, pleq, plaka dhe civilë pa armë në dorë nga radhët e armikut. E Kjo është neolufta që e mposhtë paleoluftën që vret e pret çdo gjë që gjen përpara.

Vizioni i Gani Sylës nuk është stacionimi në grupe të ngushta veprimi politik, edhe pse shumë kohë vepron si ilegal por më shumë kohë dhe veprim ilegalen e plason në lëvizje të logjikës politike për ta ndryshuar realitetin tragjik. E pra Gani Syla i trakteve, i komiteteve politike ilegale, i demonstratave dhe i agimit të luftës së nevojshme, domosdoshme dhe të pashmangshme, gjithmonë do ta ketë në mendjen e tij një temperaturë konstante, të pathyeshme dhe shpresëdhënëse për kombin. Mu për këtë jo vetëm Nëna, prindërit, vëllezërit e idealit dhe motrat e shërimit të plagëve, gjithmonë i qëndrojnë pranë, për t'i ndihmuar dhe për t'u pjekur në aksione, për t'i gjetur një ditë krah e forcë vigane e Adem Jasharit - legjendarit. Pra, gjeneratës së Adem Demaçit i ka pre sharra në një vend dhe mu për këtë ka siguruar liri dhe shtet, aq sa kemi investuar në artin e lirisë, që është liria vetë.

Libri i Gani Sylës deduktivisht është studim i brengës së individit në rasën kallëzore, por kur gjërat rrjedhin efektshëm kah e mbara ky libër prapë i kthehet trurit, dhe prej tij del një porosi se nuk ka liri dhe shtet pa iu përkushtuar me tërë qenien shpirtërore dhe fizike, aty ku ka jetë, ka shpresë për ta gëzuar. Kështu duke e lexuar me kujdes librin e Gani Sylës, rezulton shumë thjeshtë dhe shumë guximshëm se liria nuk është aq e komplikuar kur i përkushtohesh, kur ia siguron asaj frymëmarrje njerëzore-popullore kombëtare, sepse çdo gjë që është popullore dhe kombëtare as nuk mund të gjykohet e as nuk mund të dënohet, sepse e ka për qëllim çlirimin energjisë që është në shërbim të civilizimit dhe njeriut, për njeriun e vërtetë aktiv dhe sovran siç duhet të jetë kombi.

Do të thosha kur revolucionari avancohet dhe shndërrohet në patriot, atëherë nderi i kombit dhe familjes ngritët në aksiomë shkollore të Epokës së Adem Demaçit. Dhe përtej kësaj Epoke Gani Syla nuk kërkon asgjë më tepër sepse personaliteti i tij me shokë shumë, nuk është kurrë që të ketë liri më tepër për te dhe popullin e tij, se sa që i duhet. Ajo liri nuk është për asnjë grime që të i grabitë dikujt liri dhe të krijojë për veti më tepër dobi përvetësuese. Mu për këtë arsye Gani Sylaj është larg, shumë larg lagjes së shovinistëve te të gjitha ngjyrave. Është kështu sepse të huejn nuk e do, por të vetën nuk e dorëzon për asnjë interes personal, sepse ushtari i UÇK-së Gani Sylaj lirinë as nuk e shet, e as nuk e blen, atë e do të pastër si diellin që rrezaton për çdo njeri liridashës njësoj.

Çdo gjë pra në filozofinë jetësore të Gani Sylës i nënshtrohet interesit civilizues dhe kolektiv, sepse liria që e projekton Gani Sylaj duhet të mbetet pronë aktive e çdo njeriu liridashës pa dallim kombi, race, gjinie dhe kulture e religjioni. Mu nga ky parim shkolla e Adem Demaçit, së cilës i takon Gani Sylaj me shokë shumë, e ka dritën dhe besën e të gjithë atyre që lirinë, paqen dhe sovranitetin e kanë kulturë të filozofisë së historisë.

Në librin e Gani Sylajt gjatë tërë leximit vërehet një përkujdesje e pashkëputur për njeriun e rëndomtë. Është fjala se çfarë energjie intelektuale dhe fizike duhet t'i kushtohet të kaluarës,me çfarë logjike dhe energjie intelektuale duhet për t'iu përkushtuar ardhmërisë. Në mes këtyre dy poleve që duhet të bashkohen se çka duhet të fitojë kombi nesër, pra jo vet individi, te Gani Sylaj pa dilemë fiton ardhmëria edhe pse për të kaluarën ka qëndrim kritik respektiv, jo vetëm intelektual, por edhe burrëror, etik dhe pedagogjik që shqiptarizmit t'i shtojë famë prindërore dhe dituri të respektuar mësuesie të pavdekshme. E për këtë dituri flet qëndrimi i Tij në rrugën arsimore, flet qëndrimi për prindër, motrat e vëllezërit, familjen e ngushtë, njerëzit e idealit rreth tij,por kurrë nuk ndahet nga vizioni i Adem Demës. Respekt dhe admirim shkencor për një jetë të jetuar të tillë që e ka ndërtuar kalanë ashtu si e mësuan Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ashtu si e avancuan Kryengritjet e gjeneratës Hasan Prishtinës, Azem Galicës, Bajram Currrit, Shaban Polluzhës, shkollës arsimore të Petro Nini Luarasit, urtia e Shjefen Gjeçovit dhe pse jo atavizmi filozofik popullor i Naim e Sami Frashërit, Gjergj Fishtës, për t'u ngjizur me shkollën Kombëtare të Adem Demaçit, e për të shtrënguar fortë e me nderë pushkën e Lirisë së Adem Shaban Jasharit - legjendarit.

Me respekt vëllazëror për një revolucionar dhe patriot!

## Kadare në faqen e parë të "Le Monde":

# Jam i lumtur. Kam krijuar letërsi normale në një vend anormal

Gazeta prestigjioze franceze "Le Monde" i ka kushtuar faqen e parë dhe një intervistë dy faqshe shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare. Në një rubrikë të sezonit të verës të titulluar "Shkrimtarë të mëdhenj, biseda të mëdha, gazetarja Florence Noiville i ka lënë Kadaresë vendin e katër mes një cikli me pesë intervista. E tija titullohet: "në diktaturë për mua të jetoje do të thoshte të bëje letërsi".

Gazetarja ka qenë në Shqipëri që në muajin maj dhe ajo e ka intervistuar shkrimtarin në shtëpinë e tij në Tiranë. Në hyrje ajo flet për ish apartamentin e tij në rrugën e Dibrës tashmë të shndërruar në muze, për Gjirokastrën, kohën e diktaturës komuniste dhe jetën e shkrimtarit sot. "Portreti i tij nuk figuron ende në kartëmonedhat shqiptare, por ai mishëron i vetëm kulturën e këtij vendi" shkruan Noiville e cila ka biseduar me shkrimtarin duke rufitur një kafe turke të përgatitur nga bashkëshortja e tij Helena. Nga kjo intervistë e gjatë Lapsi.al ka zgjedhur të përkthejë tre pyetjet e fundit, pasi një pjesë e atyre për letërsinë e Kadaresë, marëdhënieve të tij me diktaturën dhe veprave të tij të mëhershme, janë të njohura për publikun shqiptar…


Le Monde | L'ÉTÉ

Un rapport spécial du GIEC

L'HUMANITÉ ÉPUISE LA TERRE

• Les experts de l'ONU sur l'évolution du climat avertissent sur la surexploitation des ressources de la planète, dans un rapport dévoilé jeudi 8 août

• Le GIEC estime que 72 % des terres non glacées sont sous l'emprise des activités humaines et que notre consommation par habitant explose

• La dégradation des sols et la déforestation menacent la sécurité alimentaire, appauvrissent la biodiversité et amplifient les émissions de gaz à effet de serre

• Alors que la population mondiale doit encore croître, le GIEC propose une « gestion durable des terres » et une révolution dans nos assiettes

• A cette condition, il est possible de nourrir l'humanité sans gaspillage et sans aggraver le réchauffement climatique

L'ÉTÉ DES LIVRES

ISMAÏL KADARÉ

« J'AI CRÉÉ DE LA LITTÉRATURE NORMALE DANS UN PAYS ANORMAL »

• L'écrivain albanais raconte au « Monde » comment il a pu écrire son œuvre, en surmontant la folie du dictateur

• « Shakespeare et Eschyle m'ont sauvé de l'endoctrinement »

LES INNOCENTS DE RED SPRINGS

Le mobilier du pouvoir

LE « MAGNETO » CACHÉ DU PRÉSIDENT AURIOL

La langue prend l'air

JARGON ET MOTS COMPLIQUÉS

Alzheimer

La santé du cerveau dépend aussi de l'hygiène de vie

Social

Les livreurs de Deliveroo en grève pour leur rémunération

Hongkong

Les Églises chrétiennes au cœur de la révolte

Analyse

L'économie mondiale menacée d'une overdose d'« argent gratuit »

LE REGARD DE PLANTU

Rapport du GIEC

ICD

MSc - Master of Science

**Cfarë ndjetë kur shtëpia juaj studio u inaugurua në Tiranë?**

E shoh veten përballë oxhakut. Cuditërisht me ndjenjën se jam një "shkrimtar i lirë". Gruaja ime Helena punonte në një shtëpi botuese. Cdo mëngjes unë rrija vetëm dhe shkruaja A ka gjë më të mrekullueshme? Disa nga librat e mij ishin të ndaluar, por unë shkruaja pak a shumë atë që doja. Disa herë e ndjeja që një frazë ishte e mirë. Ndonëse mund të dukej pa logjikë, unë e ndjeja bukurinë e saj të fshehur. E provoja fizikisht. Për mua cdo lloj ngushëllimi ka qenë brenda letërsisë. Dhe në misterin e të qenit i kuptuar, ndonëse vetëm prej pak vetëve.

**Mendoni se keni pasur fat?**

E njihni ju proverbin latin "Vivere militare est"? Eh.. dhe nëse të jetosh është si të luftosh duhet të jesh i lumtur nëse nuk je vrarë (qesh). Për mua të jetosh do të thotë të bësh letërsi. Të mos e bëja dot këtë detyrë do të ish njësoj sikur të mos jetoja. Unë arrita ta bëj dhe nuk u ndalova nga asgjë. Atëherë po unë kam qenë me fat. Disa herë më thonë në Shqipëri: "ah sikur të kishe jetuar në një vend të lirë". Po kush e di? Kush mund ta dijë nëse gjithçka mund të kish qenë ndryshe?


16 | L'ÉTÉ DES LIVRES

Ismaïl Kadaré

Sous la dictature, « vivre, pour moi, c'était créer de la littérature »

L'ÉTÉ DES LIVRES | 17

**Sot, kur i ktheheni veprës suaj, cila është krenaria më e madhe?**

Unë shkrova për dhjetvjecarë të tërë nën diktaturën më gjakatare të Europës së pasluftës. Sot, vite më pas letërsia ime është e njëjtë. Ajo nuk ka ndryshuar. Nëse ju nuk e shikoni datën në fund të një vepre, ju nuk e kuptoni kur është shkruar ajo. Në 2017 përshembull unë u dominova në Britaninë e mdhe për çmimin Man Booker Interntaional me "Kamarja e turpit", një tekst i shkruar në 1978 dhe dyzet vite më pas për lumturinë time juria gjykoi se leximi i saj është aktual dhe i natyrshëm. Për këtë jam i lumtur. Kam krijuar letërsi normale në një vend anormal.

*Le Monde/Pergatiti Lapsi.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Milani nderon Kosovën

Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, do të ketë festë futbolli, pasi yjet e Milanit do të zbresin në stadiumin "Fadil Vokrri" për ta zhvilluar miqësoren ndaj kampionit të Kosovës, Feronikelit. Skuadra kuqezi nga Italia në Prishtinë e sjell edhe trofeun e Ligës së Kampionëve, kurse ndeshja fillon në orën 20:45



Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 GUSHT - Futbollistët yje të skuadrës së famshme italiane AC Milan sonte (e shtunë) zbresin në stadiumin "Fadil Vokrri" për ta zhvilluar ndeshjen miqësore ndaj kampionit dhe fitueses së Kupës së Kosovës në futboll, Feronikelit. Kjo ndeshje është para edicionit të ri futbollistik në Serinë A, por edhe në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

Një ditë para ndeshjes për "Epokën e re", ka folur futbollisti i Feronikelit, Albert Dabiqaj. Futbollisti nga Deçani ka thënë se emocionet nuk po mungojnë edhe pse është vetëm ndeshje miqësore, pasi kundërshtarët janë të nivelit të lartë. "Ne po presim një ndeshje interesante dhe për ne është nder të luajmë ndaj Milanit, sepse dihet se çfarë tradite ka kjo skuadër. Pavarësisht se është vetëm një miqësore, nuk e zbeh aspak dëshirën e ne futbollistëve që të luajmë, por edhe vetë publikut që dëshiron t'i shohë nga afër idhujt e tyre. Besoj se stadiumi do të jetë i mbushur dhe të gjithë të argëtohemi në këtë festë futbolli", ka thënë Dabiqaj.

Ndërsa skuadra e Milanit ka publikuar listën e futbollistëve që do të luajnë në këtë ndeshje dhe aty nuk mungojnë emrat e mëdhenj si Piatek, Romagnoli, Suso, Donnarumma etj. Kjo ndeshje është e rëndësishëm për "Niklin" që të fitojë edhe më shumë përvojë nga përballja me skuadrat ndërkombëtare, kurse në këtë ndeshje pritet të debutojë trajneri i ri Dejan Vukiqeviq. Për ndeshjen miqësore ka folur edhe trajneri i njohur në Kosovë, Bylbyl Sokoli. Ky i fundit është shprehur se nuk ka favorit absolut në këtë ndeshje. "Nuk mund të flitet për ndonjë favorit absolut. Kuptohet, cilësia është në anën e Milanit dhe ai është favorit, por në një ndeshje miqësore edhe Feronikeli mund të bëjë ndonjë kalkulim", ka thënë Sokoli.

Dallimi në mes të Feronikelit dhe Milanit është shumë i madh. "Transfermarkt" tregon se vlera e skuadrës së Milanit është 503.5 milionë euro, përderisa futbollisti me vlerën më të madhe, plot 55 milionë euro, është portieri Gianluigi Donnarumma. Ndërsa vlera e skuadrës së Feronikelit arrin shifrën prej 2.23 milionë eurosh. Milos Krkotiq, Besmir Bojku dhe Florjan Smakiqi vlerësohen më të vlefshmit e Feronikelit me nga 200 mijë euro.

## SHKURT

### Xhaka, kapiten i Arsenalit

Trajneri Unai Emery ka lënë të nënkuptohet se Granit Xhaka do të jetë kapiten i ri i Arsenalit. "Për momentin kemi tre kapitenë: Xhaka, Nacho dhe Ozil. Unë do të zgjedh edhe dy të tjerë", ka thënë trajneri spanjoll, që në bazë të renditjes së cilësuar nga ai, i takon mesfushorit zviceran shiriti i kapitenit.

### Hazardi merr numrin 7 te Reali

Real Madridi i ka dhënë numrin 7 yllit të ri të skuadrës Eden Hazard. Futbollisti belg do ta bartë fanellën e famshme që e kanë bartur në të kaluarën legjendat si Raul e Cristiano Ronaldo. Sezonin e shkuar numri i takoi Marianos, por tani në vend të tij është ylli belg i transferuar nga Chelsea këtë verë.

### Fenerbahçe ndihet e sigurt me Muriqin në sulm

Vedat Muriqi ka pasur paraqitje të mira gjatë fazës para sezonale me ekipin e ri të Fenerbahçes. Kjo ka bërë që ta vlerësojë lart edhe trajneri i klubit, Ersun Yanal, i cili ka dhënë një raport për zyrtarët e klubit. Ai u ka kërkuar zyrtarëve të ekipit vetëm dy transferime në fazën e mbrojtjes dhe se problemet për fazën e sulmit tashmë i ka zgjidhur me shqiptarin. "Ka një përgatitje fantastike fizike. Di ta mbroj topin. Di të luajë mirë me kokë. Për një lojtar të gjatë nuk është e zakonshme të ketë kualitete të mira në pasime. Më parë kam kërkuar edhe një lojtar si partner me Muriqin, por tani dua një lojtar alternativ për lojtarin", ka thënë Yanal.

### Lucas Ferreira Kardoso huazohet te Drita

Klubi i Partizanit të Shqipërisë ka zyrtarizuar transferimin e Lukas Ferreira Kardosos te skuadra e Dritës. Sulmuesi 25-vjeçar, i cili iu bashkua kampionëve të Shqipërisë në janarin e 2018-s nga Pelisteri, do ta kalojë me formulën e huazimit në radhët e skuadrës nga Gjilani. Marrëveshja është arritur sot me pëlqimin e tri palëve dhe Kardoso do të jetë lojtar i Dritës deri në përfundim të sezonit futbollistik 2019-2020.

## Vazhdon interesimi i Realit për Pogban



MADRID, 9 GUSHT - Afati kalimtar i transferimeve në Angli tashmë është mbyllur, ndërsa klubet kanë bërë disa transferime për sezonin 2019/202. Por, Paul Pogba po kërkohet me ngulm nga Real Madridi. Sipas "L'Equipes", Zinedine Zidane po refuzon të heqë dorë nga transferimi i bashkëkombësit të tij, gjersa i ka kërkuar Florentino Perezit që ta transferojë në "Santiago Bernabeu". Nga ana tjetër, Manchester Unitedi nuk dëshiron ta shesë francezin shkaku që nuk do të mund ta transferojë zëvendësuesin e tij. Oferta e Realit besohet të jetë 120 milionë euro.

# Përfaqësuesja e Kosovës, si Prishtina e viteve të '80-ta



PRISHTINË, 9 GUSHT - Futbollistët e gjeneratës së artë, Fadil dhe Xhevdet Muriqi, janë pritur të premten nga drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi (kryetar) dhe Eroll Salihu (sekretar i përgjithshëm). Në këtë takim ishin të pranishëm edhe dy ish-bashkëlojtarët e tyre të gjeneratës së artë të Prishtinës, Skënder Shengyli dhe Sahit Kelmendi. Gjatë këtij takimi Fadil Muriqi, i cili jeton dhe vepron në Australi, i përgëzoi drejtuesit e FFK-së për suksezet e arritura deri më tash, derisa theksoi se rezultatet dhe paraqitjet e Përfaqësueses së Kosovës po i bëjnë krenarë të gjithëve, ashtu sikurse në vitet e '80-ta kur Prishtina ishte shndërruar në simbol të tërë popullit shqiptar. "Ata uruan që edhe më tutje të vazhdojë ecuria e mbarë e rezultateve të Përfaqësueses, por edhe puna e mirëfilltë që po bëhet në organizimin sa më të mirë të FFK-së, përmirësimin e infrastrukturës dhe ngritjen e cilësisë së futbollit në kampionatin vendor", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ndërkohë, presidenti Ademi i njoftoi legjendat e futbollit për strategjinë e FFK-së dhe projektet që janë realizuar dhe do të realizohen në të ardhmen me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të futbollit të Kosovës. Në fund u ndanë dhurata modeste për mysafirët.

# Berisha: Kam mentalitet fituesi, dua vetëm fitore



ROMË, 9 GUSHT - Valon Berisha synon të ketë suksese me Lazion në sezonin e tij të dytë, pasi i pari i shkoi huq. Mesfushori kosovar thotë se është një fitues i lindur dhe se jep gjithçka në fushën e blertë. Valon Berisha ka folur për objektivat e tij dhe të Lazios për sezonin e ardhshëm. Futbollisti kosovar e ka dhënë një intervistë për të përditshmen sportive italiane "Corriere dello Sport", ku ka folur edhe për lëndimet që nuk e lanë rehat sezonin e kaluar dhe për rikthimin e tij. Përfaqësuesi i Kosovës insiston se gjithmonë dëshiron të fitojë dhe për këtë e jep edhe atomin e fundit në fushën e blertë. "E kam një mentalitet fitues. Dua vetëm të fitoj në ndeshje dhe në stërvitje. Dua ta arrij një status të formës së lartë dhe të luftoj për një vend titullari", ka thënë fillimisht futbollisti i lindur dhe rritur në Norvegji.

"Para vitit të kaluar nuk kisha aq shumë lëndime. Isha ndalur vetëm një herë në të kaluarën", ka shtuar Berisha, i cili ka folur edhe për jetën e tij të re në Itali, ku thotë se nuk është aspak e lehtë dhe se ka presion për të huajt. "Ishte mjaft e vështirë të vija në Romë dhe të qëndroja i vetëm. Familja ime ishte larg, e kam ndier largësinë", ka shtuar Berisha që, megjithatë, thotë se bashkëkombësi i tij, portieri Thomas Strakosha, e ka bërë të ndihet si në shtëpi dhe atë e konsideron si një vëlla. Familja është diçka e shenjtë dhe e rëndësishme në jetën e çdo futbollisti. Madje, ai e tregon edhe arsyen se përse nuk e kishte pranuar një ofertë nga Premierliga kur ishte më i ri. "Familja ka qenë gjithmonë e rëndësishme për mua. Dëshiroja të vazhdoja të studioja, nuk isha i sigurt për një të ardhme si lojtar", ka përfunduar Berisha. Tash është koha për ta ndërruar faqen, për të shikuar përpara me optimizëm. Berisha është i gatshëm ta veshë fanellën dhe të luftojë për ta ndihmuar Lazion që ta arrijë objektivin e madh sezonal: kualifikimin në Ligën e Kampionëve.

## SHKURT

### Luizi: Cikli im në Chelsea kishte përfunduar

David Luiz ka folur si lojtar i Arsenalit. Ai ka thënë se cikli i tij në skuadrën e Chelseat kishte përfunduar, derisa me Arsenalin synon të fitojë trofe. "Cikli im në Chelsea kishte përfunduar. Bisedova me drejtuesit e Chelseat. E kisha mundësinë të vija në një tjetër klub të madh", ka thënë Luiz. "Në jetën time gjithmonë i kam dashur sfidat. Nuk frikësohem t'i provoj gjërat. Epoka ime në Chelsea kishte përfunduar dhe mezi pres ta nis një etapë të re në jetën time këtu. E njoh kualitetin e ekipit, lojtarët dhe kjo ma bën më të lehtë punën. Kam ambicie të bëj gjëra të mira dhe të fitoj trofe", ka shtuar Luiz.

### Gundogan vazhdon me Cityn

Mesfushori i Ilkay Gundogan ka nënshkruar një kontratë të re katërvjeçare deri në vitin 2023 me Manchester Cityn. Kontrata e mëparshme e Gundogan në "Etihad Stadium" përfundonte në qershor të vitit të ardhshëm. Ai u bashkua me Cityn nga skuadra e Bundesligës gjermane, Borussia Dortmund, për 25 milionë paundë në vitin 2016.

### Perisiqi, afër Bayernit

Ivan Perisiqi pritet të largohet nga Interi në këtë afat kalimtar, kurse mediet italiane kanë zbuluar se ai mund t'i bashkohet Bayern Munchenit. Sulmuesi kroat nuk bën pjesë në planet e trajnerit, Antonio Conte dhe në Bayern mund të shkojë në formë huazimi me mundësi të blerjes pas një viti në shumën prej 30 milionë eurosh.

### Donnarumma kushton 50 milionë euro

Skuadra e Paris Saint Germainit ka mësuar çmimin që duhet ta paguajë për shërbimet e Gianluigi Donnarumma. Pas largimit të Buffonit dhe Trappit nga Franca, PSG-ja është në nevojë për një portier dhe emri që po përmendet në mediet italiane është ai i Donnarummas. "Gazzetta dello Sport" raporton se Milani është gati ta shesë yllin e vet për 50 milionë euro.

### Tyson mashtroi me analizat

Mike Tyson nuk i ka zhgënjyer asnjëherë tifozët duke i befasuar me veprimet e tij, qofshin ato në ringun e boksit ku impresiononte me egërsinë përtej limitit, ashtu edhe në intervista televizive. Në një të tillë së fundmi, Mike i hekurt, siç e kanë pagëzuar mediet prej dekadash, ka pranuar se ka mashtruar në jo pak raste autoritetet e kontrolleve antidoping. "Kam përdorur urinën e fëmijëve të mi për të mos u zbuluar në testet antidoping. Si e bëja këtë? Më ndihmonte gjithmonë stafi mjekësor dhe në momentet e provës, çdo kontrollor nuk preferonte të më vështronte duke më dhënë mundësinë të përdorja këtë truk në teste".

Michael Gerard Tyson, i lindur më 30 qershor 1966, dominoi për shumë vite në ringun profesionist. Tifozët ende kujtojnë veprimet e tij kafshërore në një ndeshje të vetme kundër Evander Holifildit, që u privua nga një pjesë e veshit gjatë një dyluftimi që kaloi çdo limit.



Autor: GAZMEND MORINA

- BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE, ME KËRCELL TË GJATË (sh.shq.)
- SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR
- EMËRORE, RASA E PARË E LAKIMIT (gram.)
- LLOJ PAPAGALLI
- FUTBOLLISTI ALTIN ....
- SHTET I LASHTË NË EVROPË
- NJË NGJYRË
- I ÇMPREHE
- ME VËSHTIRËSI, ME SHUMË MUNDIM
- EPOKA E RE
- PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE
- MBARIM, PËRFUNDIM
- BASHKËTING. / TEFIK OSMANI
- PAMORAL-SHMËRIA
- SHTET NË AFRIKË (pashq.)
- GAZ QË PËRDORET PËR TË PASTRUAR PLAGËT / ANA MERO
- REGJISORI GJERMAN ... EDEL / QYTET I YNI
- ZEZAKU; I ZIU / ISH BENDI MUZIKOR ANGLEZ "...... KITTEN"
- ZANORE / RRJET I QARKULLIMIT TË AUTOMJ-ETEVE
- PËREMËR PRONOR
- DY BASHKË-TINGËLLORE / RRYMË AJRI QË LËVIZ NË DREJTIME TË NDRYSHME
- PIKTORI YNË .... VALLA
- ZANORE / BËRJE MË I RI
- AKTORJA AMERIKANE .... GARR / ALTINI (perkdh.)
- KUJDESTAR (lat.)
- KA A DEM I PATREDHUR / MARKË E TELEFONAVE CELULAR
- EPOKA E RE
- KËNGËTARJA KANADEZE NË FOTO LAVIGNE
- KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVROPIAN
- ZBAVITËS, TËRHEQËS
- NIKEL
- KUFI
- ZANORE
- QYTET NË ITALI / MALËSOR
- "F" në mes të dy "A" / PRAROJ
- GRADIM, PËRPARIM
- AKTORJA AMERIKANE ...... RYDER (shqip.) / MOTOÇIKLETA (bised.)
- ZANORE / MARRJE E TIPAREVE TË PARAARDHË-SVE TANË
- PËRGËZIM
- QYTET NË KOSOVË
- ALYSA MILANO / MOR, HEJ (pasth.)
- BIMË QË BËN KOKRRA TË THARA (shq.) / ENDACAKE
- RENIUM, REOMIR
- SKLLAV I LIRUAR (hist.) / FUTBOLLISTI BRAZILIAN ..... SILVA (MILAN)
- NOTË MUZIKORE / KALORËS MESJETAR
- OHAJO, LUIZIANA / AKTORI YNË .... HAZIRI
- BASHKËTING. / KËNGËTARJA SHQIPTARE ANILA ......
- ZEMËRIM, EGËRSIM
- PJESË RROTULLUESE E NJË APARATI / MITRUSH KUTELI
- SHKOLLIMI, ARSIMIMI (bised.) / ARKIVI I FILMAVE
- LAKESË
- AKTOR KOMEDISH / MODELJA SHQIPTARO-AMERIKANE ÇUNMULAJ
- ZANORE / BASHKËTING.
- SHTEG / SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE (pashq.)
- EPOKA E RE
- QESËNDISJE
- KËNGËTARJA ANITA .... / TMERR
- ZYRTARIZIM I NJË MARR-ËVESHJE NDËRKOM-BËTARE / BURIMI
- SMIRË
- I DOBËT; TINËZAR
- BENDI MUZIKOR "IRON ......." / PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR UDHËZIMESH (shq.)
- SHPEND I EGËR ME BISHT TË GJATË / DETERGJENT PËR DUAR
- SHFUQIZIM I NJË AKTI JURIDIK
- KËNGËTARI ITALIAN RAMAZZOTTI / DREJTOJ NJË AUTOMJET
- KËNGËTARJA JONË .... SHKODRA / BASHKËTING.
- OMANI, BENINI
- FUTBOLLISTI BEHRAMI
- BASKETBOLL-ISTI TURK OMER .... / AKTORI FRANCEZ DELON (shq.)
- MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAHU
- GOTË PREJ METALI / BASHKËTING.
- SHOK, JARAN / GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ
- SHTET FEDERAL NË SHBA
- MYNXYRË; HALL I MADH / AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBREN
- PESCARA, IVREA / AKTORJA ME FAMË BOTËRORE .... REID
- ZANORE / SHTRESË E SIPËRME E AJRIT
- SHTET NË EVROPË (pashq.)
- "R" pas dy "A" / AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS
- ARKË SHUMË E VOGËL PREJ KARTONI
- ERBIUM / EUROPEAN TRAIN ENTHUSIAST
- KAMBANË FARE E VOGËL
- BOSHTI / ARIAN MALIQI
- JETËSHKRIM (sh.shq.) / DY BASHKË-TINGËLLORE
- TONY ANDERSON
- ZANORE
- MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT / ISLANDA
- SHKRONJA XXVIII & XXVI
- PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA / URUGUAI
- I ULËT E I TILLË SA MË S'BËHET
- FILLIMI I AGIMIT
- SKANDALI

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: FINALIZIM, D, AMORALITETI, SOMALI, OZON, ULI, ARAPI, A, KLINA, IMI, TM, ESAT, A, TERI, TUTOR, TERAK, RIMINI, AFA, AVANCIM, VINONA, I, VITIA, AM, KIKIRIKU, RER, KOLON, MI, OL, R, INAT, ROTOR, ARSIMI, LAKIM, KOMIK, A, RIM, TAKE, RATIFIKIM, I, LIG, MAIDEN, FAZAN, REVOKIM, EROS, TINA, OB, ONAN, TAS, MIK, NEVADA, GAZEP, PI, A, ITALI, AAR, KUTI, ER, ZILE, AKSI, ANALET, I, ONANI, TS, IRATET, MINIMAL, AGU, AFERA.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
...stria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Hea...
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova –
Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
Prizren

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Udhëzimin Administrativ (MPMS)Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në nenin 10 të (SHSKUK), Nenit 62, pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, kërkesës për rekrutim nr.2/132, të datës13.06:2019, të aprovuar nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së më datën 18.06.2019, ndryshimit të lejuar nga ZKF, datë09.08.2019, si dhe nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

**KONKURS PUBLIK**

Për pranimin në marrëdhenie pune dhe atë:
Titulli i vendit të punës:
**1. Infermier/e i përgjithshëm –bachelor: 5 vende pune**
**Koeficineti i pagës:** 5.40
**Norma e punës:** Orar i plotë
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore
**Qëllimi kryesor i vendit të punës:** Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të nivelit sekondar në kuptimin cilësor e sasior në reparte, bazuar në nivelin profesional që ka mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
2. **Infermiere mami –bachelor: 2 vende pune**
**Norma e punës:** Orar i plotë
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore
**Qëllimi kryesor i vendit të punës:** Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të nivelit sekondar në kuptimin cilësor e sasior në reparte, bazuar në nivelin profesional që ka mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
**3. Pastrues/e për shërbimin e lartores: 2 vende pune**
**Koeficineti i pagës:** 4
**Norma e punës:** Orar i plotë
Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore
**Qellimi kryesor i vendit:** Ofrimi i shërbimeve në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nevojat e reparteve dhe njësive, me theks të veçant në lartore.
**4. Punëtor/e administrativ: 1 vend pune**
**Koeficineti i pagës:** 4.8
**Norma e punës:** Orar i plotë
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore
**Qellimi kryesor i vendit të punës:** Ofrimi i shërbimeve në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nevojat e reparteve dhe njësive, me theks të veçant njësinë e transportit dhe autoparkut.
**Numri i references: 8/33, datë; 09.08.2019**
1. Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës **Infermier/e i/e përgjithshme (bachelor):** Fakulteti i kryer – Infermieri e përgjithshme
**Dokumentacioni i kërkuar:**
1. Diploma e fakultetit të mjekësisë, drejtimi infermier i përgjithshëm – (origjinal apo kopje e vërtetuar)
2. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë valide (origjinal apo kopje e vërtetuar)
3. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
4. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
5. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)
**2. Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës Infermiee mami bachelor: Fakulteti i kryer – Infermiere mami**
**Dokumentacioni i kërkuar:**
1. Diploma e fakultetit të mjekësisë, drejtimi infermier e mami – (origjinal apo kopje e vërtetuar)
2. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë valide (origjinal apo kopje e vërtetuar)
3. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
4. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
5. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)
**3. Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës pastrues/e:** Shkolla e mesme
**Dokumentacioni i kërkuar:**
1. Çertifikata mbi kryerjen e shkollës së mesme
2. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
3. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
4. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)
**4. Kualifikimet e nevojshme për vendin e punës punëtor/e administrative:** Shkolla e mesme
**Dokumentacioni i kërkuar:**
1. Diploma mbi kryerjen e shkollës së mesme
2. Çertifikata e lindjes (origjinal apo kopje e vërtetuar) dhe fotokopja e letërnjoftimit
3. Çertifikata që nuk jeni i dënuar ose nën hetime (origjinal apo kopje e vërtetuar)
4. Çertifikata mbi gjendjen shëndetësore (pas pranimit në marrëdhënie pune)
**Kushtet për pjesmarrje në rekrutim për të gjitha pozitat:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikes së Kosovës që kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe i plotësojnë kushtet sipas konkursit për vendin e punës për të cilin aplikojnë.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.
Aplikacioni merret në Administratë të Spitalit. Aplikacioni me dokumentacion përcjellës dorëzohen në Administratën e Spitalit në Prizren, rruga "Sheh Emini" p.n. çdo ditë pune prej orës 7:00-15:00. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Prizren, 09.08.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva-Sağlık Bakanlığı
SHSKUK - UBKSK - KUHKH
SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE
"Prim. Dr. Daut Mustafa"
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org.Bölümü: I
Nr.Prot. / Br.Prot. / Prot.No.: 8/33
Nr.i faqeve / Br.stranica / Sayfa no.: 1
Data / Datum / Tarih: 09.08.2019
P R I Z R E N

Drejtori Administratës
Ma.sci.Melinda Çollaku

---

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Hea...
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova –
Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
Prizren

Na osnovu člana 8 Zakona br. 03 / L-212 o radu, Administrativnog uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o regulisanju procedura javnih konkursa, članu 10 (KSSHC), član 62, tačka 6, Zakona br. 04 / L-125 o zdravstvu, prijavu za zapošljavanje br. 2/132 od 13.06.2019 godine, odobrenog od strane generalnog direktora KSHKUK dana 18.06.2019, promena od strane ZKF, dana 09.08.2019, kao i član 13, tačka 1.1. Statuta Bolnice, Upravni odbor Opšte bolnice objavljuje:

**Javni Oglas**

Za prijem u radni odnos:
Naziv radnog mesta :
**1. Opsta medicinska sestra/tehnicar -bachelor: 5 radna mesta**
**Koeficienat: 5. 4**
**Radni standard:** Puno radno vreme
**Trajanje ugovora:** Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri) meseca
**Qëllimi kryesor i vendit të punës:** Glavna svrha radnog mesta: Omogućivanje zdravstvenih usluga sekundarnog nivoa u kvalitativnom i kvantitativnom smislu na odeljenjima, zasnovano na profesionalnom nivou ljubaznosti, nege i poštovanja pacijenta i osoblja.
**2. Babica -bachelor: 2 radna mesta**
**Koeficienat: 5. 4**
**Radni standard:** Puno radno vreme
**Trajanje ugovora:** Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri) meseca
Glavna svrha radnog mesta: Omogućivanje zdravstvenih usluga sekundarnog nivoa u kvalitativnom i kvantitativnom smislu na odeljenjima, zasnovano na profesionalnom nivou ljubaznosti, nege i poštovanja pacijenta i osoblja.
**3. Čistac/ica: 3 radna mesta**
**Koeficienat:** 4
**Radni standard:** Puno radno vreme
**Trajanje ugovora:** Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri)2meseca
Glavna svrha radnog mesta: Pružanje usluga u kvalitativnom i kvantitativnom smislu zasnovanim na potrebama odeljenja i jedinica, sa posebnim naglaskom na gore navedeno.
**4. Administrativni radnik- iedna pozicija**
**Koeficienat: 4.8**
**Radni standard:** Puno radno vreme
**Trajanje ugovora:** Neograničeno sa probnim radom od 3 (tri) meseca
Glavna svrha radnog mesta: Pružanje usluga u kvalitativnom i kvantitativnom smislu zasnovanom na potrebama odeljenja i jedinica, sa posebnim naglaskom na jedinicu za transport i autopark.
Broj referce: 8/33, datum 09.08.2019

1. Neophodne kualifikacije za radno mesto **Bachelor opsteg srestinstva:** medicinski fakulteta, smer opsteg sestrinstva
**Potrebna dokumentacija:**
1. Diploma medicinskog fakulteta, smer opsteg sestrinstva ( original ili overena kopija)
2. Licenca rada Ministrastva Zdravlja ( original ili overena kopija)
2. Izvod iz maticne knjige rodjenih (original ili overena kopija) i fotokopija licne karte
3. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom (originalu ili overena kopija).
4. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos) Ugovor o Radu: Na neodredjeno vreme sa 3 (tri) meseci probnog rada.
2. Neophodne kualifikacije za radno mesto Babica **Bachelor :** medicinski fakulteta, babicki smer
**Potrebna dokumentacija:**
1. Diploma medicinskog fakulteta, babicki smer ( original ili overena kopija)
2. Licenca rada Ministrastva Zdravlja ( original ili overena kopija)
2. Izvod iz maticne knjige rodjenih (original ili overena kopija) i fotokopija licne karte
3. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom (originalu ili overena kopija).
4. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos) Ugovor o Radu: Na neodredjeno vreme sa 3 (tri) meseci probnog rada.
3. Neophodne kualifikacije za radno **mesto cistac/ica:** Zavrsena srednja skola
**Potrebna dokumenta:**
1. Diploma o zavrsenoj osnovnoj skoli ( original ili overena kopija)
2. Izvod iz maticne knjige rodjenih ( original ili overena kopija) i fotokopija licne karte
3. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom( originalu ili overena kopija).
4. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos) Ugovor o Radu: Na neodredjeno vreme sa 3(tri) meseci probnog rada.
4. Neophodne kualifikacije za radno mesto **Administrativni radnik:** Zavrsena srednja skola
**Potrebna dokumenta:**
1. Diploma o zavrsenoj osnovnoj skoli ( original ili overena kopija)
2. Izvod iz maticne knjige rodjenih ( original ili overena kopija) i fotokopija licne karte
3. Uverenje da niste osudjeni ili pod istragom( originalu ili overena kopija).
4. Uverenje o zdravstvenom stanju (posle primanja u radni odnos) Ugovor o Radu: Na neodredjeno vreme sa 3(tri) meseci probnog rada.
**Uslovi za prijem u rekrutaciju:** Pravo na rekrutaciju imaju svi drzavljani Republike Kosova koji su zavrsili adekvatnu spremu za radno mesto za koje konkurisu.
Oglas ostaje otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u javnim medijima.
Aplikacije se dobijaju u administraciji bolnice. Prijava sa pratećom dokumentacijom se podnosi Upravi bolnice u Prizrenu, ulica "Sheh Emini" bb. svakog radnog dana od 7:00 do 15:00. Prijave podnesene nakon isteka roka nece biti prihvaćene, dok ce nepotpune prijave biti odbijene.

Prizren, 09.08.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti
Ministria e Shëndetësisë
Ministavstvo Zdravstva-Sağlık Bakanlığı
SHSKUK - UBKSK - KUHKH
SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE
"Prim. Dr. Daut Mustafa"
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org.Bölümü: I
Nr.Prot. / Br.Prot. / Prot.No.: 8/33
Nr.i faqeve / Br.stranica / Sayfa no.: 1
Data / Datum / Tarih: 09.08.2019
P R I Z R E N

Direktor Administracije
Ma.sci. Melinda Çollaku

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

**Komisioni Vlerësues i Ofertave** (*i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, 01. nr. 016-60480, të dt. 30.05.2019*), duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (*"Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.10/03 Prill 2019 "*), me qëllim të zbatimit të Vendimeve Paraprake të Kuvendit Komunal (*Vendimi nr. 01.016-32289 i datës 19.03.2014 si dhe Vendimi nr. 01.016-126427 i datës 29.12.2016*) për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronave të Paluajtshme të Komunës), **në takimin e mbajtur me datë 29.07.2019, mori vendim për shpalljen e :**

# NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

## PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit: personat fizik dhe juridik që të shfrytëzojnë mundësinë e marrjes në shfrytëzim me afat kohor :

- **10-vjeçar banesat dhe lokalet afariste**
- **5-vjeçar vend parkingjet e automjeteve**

**I.Njësitë banesore për banim në kuadër të ndërtesës te Kombinati i Duhanit:**

1. Njësia me numrin kadastral: **O-70403013-02447-1-219-1-14-0, banesë 3 dhomëshe, me sipërfaqe prej 86 m², gjendet në katin e V-të, hyrja e I-rë.** (*Numri identifikues i banesës 1.7*)

**2.** Njësia me numrin kadastral : **O-70403013-02447-1-219-3-41-0, banesë 4 dhomëshe, me sipërfaqe prej 103.5m², gjendet në katin e VI-të, hyrja e III-të.** (*Numri identifikues i banesës 1.8*)

**II.Njësitë banesore për banim në kuadër të ndërtesës te ish- Objekti i Kadastrit:**

1. Njësia me numrin kadastral: **O-70403013-03532-0-214-0-26-0, banesë 2 dhomëshe, me sipërfaqe prej 69 m², gjendet në katin e IV-të.** (*Numri identifikues i banesës 1.2*)

3. Njësia me numrin kadastral: **O-70403013-03532-0-214-0-27-0, banesë 3 dhomëshe, me sipërfaqe prej 80 m², gjendet në katin e V-të.** (*Numri identifikues i banesës 1.6*)

5. Njësia me numrin kadastral: **O-70403013-03532-0-214-0-20-0, banesë 2 dhomëshe, me sipërfaqe prej 76 m², gjendet në katin e III-të.** (*Numri identifikues i banesës 1.4*)

*Kushtet e veçanta të ankandit për njësitë banesore të përshkruara në pikën I dhe II :*

*a) Çmimi fillestar i banesave : 0.50 €/ m² në emër të qirasë mujore,*
*b) Përzgjidhet oferta me çmimin më të lartë të ofruar në ankand,*
*c) Në rast se në ankand ofrohen dy apo më tepër çmime më të larta të njëjta, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertuesve, në prani të tyre dhe Komisionit për vlerësimin e ofertave.*

**III.Lokalet afariste në kuadër të ndërtesës te Kombinati i Duhanit:**

1. Njësia me numrin kadastral: **O-70403013-02447-1-219-2-1-0, lokal afarist me sipërfaqe 83.9 m², gjendet në katin e I-rë, hyrja e II-të.** (*Numri identifikues i lokalit 1.3*).

**2.** Njësia me numrin kadastral: **O-70403013-02447-1-219-1-1-0, lokal afarist me sipërfaqe 73.5 m², gjendet në katin përdhese, hyrja e I-të.** (*Numri identifikues i lokalit 1.1*).

*Kushtet e veçanta të ankandit për lokalet afariste të përshkruara në pikën III :*

*a) Çmimi fillestar i lokaleve afariste : 2.00 €/ m² në emër të qirasë mujore,*
*b) Përzgjidhet oferta me çmimin më të lartë të ofruar në ankand,*
*c) Në rast se në ankand ofrohen dy apo më tepër çmime më të larta të njëjta, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertuesve, në prani të tyre dhe Komisionit për vlerësimin e ofertave.*

**IV. Vend parkingjet në qytet :**

1. Lokacioni tek ish objekti i Kadastrit, ngastra kadastrale P-70403013-03765-0 me sipërfaqe prej 2491m². Në shfrytëzim jepet sipërfaqja përafërsisht prej 1263 m² e cila do të përcaktohet saktë para lidhjes së kontratës me përfituesin potencial nga ankandi publik.
2. Lokacioni tek rruga "Xhemajl Mustafa" ( te parku i qytetit), ngastra kadastrale P-70403013-04507-0 me sipërfaqe prej 2932 m². Në shfrytëzim jepet sipërfaqja e përafërt prej 350 m² e cila do të përcaktohet saktë para lidhjes së kontratës me përfituesin potencial nga ankandi publik.
3. Lokacioni tek QKMF-ja dhe para objektit të NTP "Ciri", ngastrat kadastrale P-70403013-03539-0 me sipërfaqe prej 1883 m² dhe 70403013-03602-0 me sipërfaqe prej 3400 m². Në shfrytëzim jepet një sipërfaqe e përafërt prej 676 m² nga të dyja këto ngastra e cila do të përcaktohet saktë para lidhjes së kontratës me përfituesin potencial nga ankandi publik.
4. Lokacioni përballë shkollës së Mesme Teknike "Mehmet Isai" ngastra kadastrale nr.P-70403013-04767-0 me sipërfaqe prej 12014 m². Në shfrytëzim jepet sipërfaqja e përafërt prej 201 m² e cila do të përcaktohet saktë para lidhjes së kontratës me përfituesin potencial nga ankandi publik.

**Kushtet e përgjithshme të ankandit publik për vend parkingjet e përshkruara në pikën IV:**

1. Vend parkingjet jepen në shfrytëzim në **periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe në pako (të gjitha këto lokacione fitohen nga ofertuesi me çmimin më të lartë të ofertuar).**
2. Të drejtë pjesëmarrje kanë vetëm personat juridikë- kompanitë të cilat janë të pajisura me Certifikatë – numër të biznesit dhe me numrin fiskal.
3. **Çmimi fillestar për dhënien e vend parkingjeve në shfrytëzim është 4.00 €/m² (katër euro) në emër të qirasë vjetore.**
4. Shfrytëzimi i pronës mund të bëhet vetëm për parkingje të automjeteve dhe për mjete tjera motorike.
5. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjet (15) ditë nga **dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës**, në vendet publike dhe në media lokale, elektronike dhe të shkruara. **Ofertat dorëzohen të mbyllura (në pliko), nëpërmjet Qendrës për Shërbim me Qytetar, (rr."Bulevardi i Pavarsisë" nd.Soliteri, kati përdhesë), deri me datën 23.08.2019, në ora 12:00 h dhe të protokollohen nga komuna.**
6. **Personat juridik** ofertës duhet bashkangjitur: **Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit** me informata mbi biznesin, **Vërtetimin nga ATK-ja mbi obligimet e kryera** dhe **Vërtetimin e Tatimit në Pronë (të pronarit të biznesit).**
7. **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** Në sallën e Kuvendit Komunal, (Objekti i ish Gjykatës Komunale, kati përdhesë), me datën **23.08.2019** , në fillim në ora **13:30 h**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.
8. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të: informohen lidhur me procedurat e ankandit publik, vizitojnë (shohin) pronat që do të jepen në shfrytëzim me dt. **20.08.2018** me fillim: nga ora **10:00-12:00 h**.
9. **Në të gjitha vend parkingjet duhet të jetë i rezervuar edhe nga një parking për personat me aftësi të kufizuar.**

**Kushtet e përgjithshme të ankandit publik për banesa dhe lokale afariste :**

1. Çmimi fillestar i pronave të cilat janë objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit është i përcaktuar në kushtet e veçanta edhe ate: për banesa: **0.50 €/m²/në muaj**, për lokale afariste: **2.00€ / m²/ në muaj**.
2. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës (banesave dhe lokaleve) do të jetë afatshkurtër prej **dhjetë (10) vite.**
3. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat fizik të cilët marrin pjesë, duhet ofertës bashkangjitur: **fotokopjen e dokumentit valid të identifikimit – letërnjoftimin dhe Vërtetimin e Tatimit në Pronë. Personat juridik** ofertës duhet bashkangjitur: **Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit** me informata mbi biznesin, **Vërtetimin nga ATK-ja mbi obligimet e kryera** dhe **Vërtetimin e Tatimit në Pronë (të pronarit të biznesit).**
4. Shfrytëzimi i pronës mund të bëhet vetëm sipas destinimit të cilin e kanë: banesat për banim, lokalet afariste për afarizëm dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.
5. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjet (15) ditë nga **dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës**, në vendet publike dhe në media lokale, elektronike dhe të shkruara. **Ofertat dorëzohen të mbyllura (në pliko), nëpërmjet Qendrës për Shërbim me Qytetar, (rr."Bulevardi i Pavarsisë" nd.Soliteri, kati përdhesë), deri me datën 23.08.2019, në ora 12:00 h dhe të protokollohen nga komuna.**
6. **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** Në sallën e Kuvendit Komunal, (Objekti i ish Gjykatës Komunale, kati përdhesë), me datën **23.08.2019** , në fillim në ora **13:30 h**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

7. Prona nuk mund të përdoret për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik (pika 4). E njëjta nuk mund të bartet në personin e tretë, të epet nën qira dhe nuk mund të jetë objekt i pengut (hipotekës) apo çfarëdo barre tjetër në raport me personat e tretë. Nga koha e nënshkrimit të kontratës mbi qiranë, shfrytëzuesi i fiton të gjitha të drejtat mbi shfrytëzimin e qetë të asaj prone por gjithashtu obligohet për pagesën e të gjitha taksave komunale dhe pagesave tjera të cilat burojnë nga marrëdhënia kontraktuese mbi qiranë duke përfshirë edhe **tatimin mbi qiranë.**
8. Përfituesit e njësive banesore dhe lokaleve afariste nga ankandi i kaluar nuk kanë të drejtë pjesëmarrje në ankand për llojin e njejtë të pronës ( përfituesi i banesës nuk ka të drejtën e aplikimit për banesë dhe përfituesi i lokalit nuk të drejtën e aplikimit për lokal).
9. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të: informohen lidhur me procedurat e ankandit publik, vizitojnë (shohin) pronat që do të jepen në shfrytëzim me dt. **20.08.2018** me fillim: nga ora **10:00-12:00 h**.
10. **Pjesëmarrësit kanë të drejtën e qasjes në dokumentacionet e pronës, të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tri (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik. Në rast se ndonjëri nga aplikuesit në ankand dëshiron të tërhiqet gjatë procesit të hapjes së ofertave dhe zhvillimit të ankandit, aplikacioni i tij fare nuk hapet duke e konsideruar se i njëjti është tërhequr nga ankandi. Në rast se fituesi i ankandit tërhiqet para lidhjes së kontratës, ankandi duhet anuluar në atë pjesë dhe duhet rishpallur. Çdo person fizik dhe juridik, pjesëmarrës në ankand publik, mund të jetë fitues vetëm i një banese, gjegjësisht lokali afarist . Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmohen si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë aplikacionin dhe ta përjashton nga procedura e ankandit.**

11. <u>Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:</u>

Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:
-Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
-Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
-Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
-Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur;
-Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.

Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. **Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjatë procesit te hapjes se ofertave.** Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë **"Komisionit për vlerësimin e ankesave"** në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Nëse Komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.

Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e Komisionit vlerësues.

**<u>Vërejtje:</u> Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik mund të bëhet : në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetar në Gjilan kurse në formë elektronike në Ueb faqen e Komunës.**

**Nuk lejohet që në një aplikacion të ketë më shumë çmime ofertuese apo të ofertohet për më shumë prona. Për çdo pronë duhet aplikacioni dhe pliko e veçantë. Çmimet e ofertuara duhet të epen për njësinë (€/ m²). Vlen rregulli :** ***Një pronë- një aplikacion- një ofertë. Plikot të cilat përmbajnë dy apo më shumë aplikacione apo dy apo më shumë oferta, Komisioni do t'i shpallë të pavlefshme dhe do të përjashtohen nga procedura e ankandit.***

**Gjilan, 09.08.2019** **Komisioni Vlerësues i Ofertave**

/Sali Fazliu, Kryesues/

- Për informata më të hollësishme dhe për sqarimin e paqartësive eventuale lidhur me procedurat e ankandit, mund të kontaktoni : ***e-mail :*** *<u>sali.fazliu@rks-gov.net</u>*, ***tel: +377 44 144 364, për çdo ditë pune nga ora 08:00h - 16:00h.***







## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Auto-Taxi" shpall të pavlefshëm certifikatën e regjistrimit të biznesit më numër: 810468604 dhe nr.fiskal: 600410609.

► N.T. "Baholli Colors" nga Prishtina shpall të pavlefshëm certifikatat e regjistrimit të biznesit më numër: 80077629, nr.fiskal: 600019386 dhe nr.TVSh: 330039174.

► Adis Sofiu shpallë të pavlefshëm dëftesat dhe diplomën certifikatën e maturës të lëshuar nga SH.M.M. "Luciano Motroni" Prizren.

► Floriana Cikaqi shpalle te pavlefshëm dëftesat dhe diplomën e gjimnazit "Remzi Ademaj" Prizren.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.


TELEKOMI I KOSOVËS URON BESIMTARËT ISLAM
ME FAT KURBAN BAJRAMI
vala
KOSOVO TELECOM
www.kosovotelecom.com


me fat
Kurban
Bajrami
KEDS
KES|CO